

PËR MËSUESIN/EN

duk^agjini
shtëpia botuese publishing house

Merita Dervishaj, Arita Ademi

SHKATHHTËSI PËR JETË

Për klasën e dytë të arsimit fillor

2

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes	4
Hyrje	6
Planifikimi vjetor	14
Plani dymujor: shtator—tetor	15
Plani dymujor: nëntor—dhjetor	18
Plani tremujor: janar—shkurt—mars	21
Plani tremujor: prill—maj—qershor	24
Mësimi 1: Materialet dhe përpunimi i tyre	28
Mësimi 2: Vetitë e materialeve	30
Mësimi 3: Llojet e materialeve	32
Mësimi 4: Krahasimi i materialeve	34
Mësimi 5: Ndryshimi i formës së gjësendeve të përbëra nga materialet e ndryshme	36
Mësimi 6: Punë praktike - Punimi i mbajtëses së lapsave	38
Mësimi 7: Rregullat e trafikut	40
Mësimi 8: Roli i policit në rrugë	42
Mësimi 9: Llojet e trafikut	44
Mësimi 10: Zbatimi i rregullave të këmbësorëve	46
Mësimi 11: Shenjat e komunikacionit	48
Mësimi 12: Modelojmë shenjat e komunikacionit	50
Mësimi 13: Llojet e profesioneve	52
Mësimi 14: Përshkrimi i profesioneve	54
Mësimi 15: Emërtimi i profesioneve dhe i mjeteve të duhura	56
Mësimi 16: Lojë në grupe	58
Mësimi 17: Si ta organizojmë festën e ditëlindjes?	60
Mësimi 18: Nxënësit rregullojnë klasën	62
Mësimi 19: Tregim - Klasa humanitare	64
Mësimi 20: Çfarë duhet ditur për kursimet në familje?	66
Mësimi 21: Planifikimi i kursimit në familje	68
Mësimi 22: Planifikimi familjar - Lojë skenike	70
Mësimi 23: Zbatimi i rregullave të higjienës dhe kujdesi për veten	72
Mësimi 24: Rregulla të tjera për mbajtjen e higjienës personale, të mjedisit në shtëpi dhe shkollë	74
Mësimi 25: Higjiena personale	76
Mësimi 26: Mënyra e veprimit me rastin e paraqitjes së ndonjë sëmundjeje	78
Mësimi 27: Veprimet që kryhen për mbajtjen e pastërtisë	80
Mësimi 28: Pastërtia e mjedisit që ju rrethon	82
Mësimi 29: Klasifikimi i mbeturinave sipas llojit dhe materialit	84
Mësimi 30: Shkaktarët e ndotjes së ambientit	86
Mësimi 31: Frutat dhe perimet	88
Mësimi 32: Mediet dhe llojet e tyre	90
Mësimi 33: Mjetet e informimit dhe programet e parapëlqyera	92
Mësimi 34: Lojë skenike - Rinori dhe Alba	94
Mësimi 35: Lojë skenike - Rinori dhe Alba (përsëritje)	96
Mësimi 36: Fletushka e klasës	98
Mësimi 37: Fletushka e klasës - Punë në grupe	100

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënit dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES

për konceptimin e mësimeve model

Faqja në të majtë


Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.

Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zëbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.



Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Të gjitha mjetet dhe materialet që ndihmojnë në konkretizim.

Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.


Metodologjia e mëimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Për t'i përforcuar dijet dhe shkathësitë, në fund të mëimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mëimit, ku, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënësit bëhet më tërheqës dhe nxënësit bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.

Veprimtaritë në këtë hap a këta hapa të mëimit udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mëimit

Rezultatet e të nxënit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve dhe mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënës. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënës të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënës: Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënës të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zbërthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënësit - hapat e zhvillimit të mësimi: Meqenëse nxënësit e klasës së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, prandaj edhe të menduarit e tyre është paraoperacional, kështu që mësimi kalon përmes hapave.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?



Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura jepen së bashku, njëra pas tjetrës, çka sugjeron që mësuesi duhet ta ndërtojë mësimin mbi të mëparshmen dhe ta ketë parasysh se çfarë mund të vijojë. Sikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.

Në këto klasa mësimi zhvillohet në hapa, të cilët, sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do ta ndjekë këtë ecure.

Hyrje: Identifikohen njohuritë dhe shprehjet fillestare të nxënësve që të nxiten interesi i tyre për mësimin.

Pjesa kryesore e mësimi: Mësuesi/ja, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, synon ta bëjë tërheqës të nxënës të mësimi përmes veprimtarive të ndryshme, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese, figura, tabela, fotografi, video dhe të tjera.

Praktikë e udhëhequr: Veprimtaritë në këtë etapë të mësimi kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Praktikë e pavarur: Nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

SHKATHTËSI PËR JETË 2

Përderisa përgatitja për jetë dhe për punë theksohet në tërë kurrikulën si një çështje e rëndësishme, fusha e Kurrikulës *Jeta dhe puna* synon të kontribuojë veçanërisht si një fushë “mbartëse” në zhvillimin e kompetencave për jetë dhe për punë. Në shkallën 1 dhe 2 të kurrikulës, ajo përqendrohet në shkathhtësitë për jetë, krahas shkathhtësive që kanë të bëjnë me artizanatet dhe amvisërinë. Përmes kësaj fushe të kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si: anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijesimin dhe vetëbesimin duke qenë po ashtu të vetëdijshëm për ekzistimin e të tjerëve dhe nevojës për t’u mbështetur në marrëdhënie ndërpersonale në jetë dhe në punë, për sa i përket tolerancës dhe respektit të ndërsjellë. Ata do ta zhvillojnë shpirtin për iniciativë dhe përgjegjshmëri; do t’i hartojnë dhe do t’i respektojnë planet e punës dhe afatet kohore, si dhe do të njihen me cilësinë e proceseve dhe të rezultateve të tyre.

Udhëzime metodologjike


Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën kurrikulare *Jeta dhe puna*, mund të përdoren metodat e ndryshme të punës, me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo fushë, por edhe për shkak të specifikave që bart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësit.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënësit

Ky libër është hartuar për t’ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathhtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje me “Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës” (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjithë elementet përbërës, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënësit të fushës, rezultatet specifike të të nxënësit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimi e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*.

Qëllimi i kësaj rubrike është që t’ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mossuksesin, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënësit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënësit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndësh magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënësit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënësit dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathhtësive.



Burimi: *Metodologji e mësimdhënies*, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014)

Metodologji e mësimdhënies. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e zhvillimit proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhësë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuar në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar japin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe formimin e shprehive.



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011)

Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës 1

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
2.	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar, gjatë diskutimit në grup, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
4.	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
5.	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimi, vizatimi, dramatizimi (luajtja në role), këndimi apo vallëzimi.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është e përshtatshme për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
7.	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve.
8.	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo interpretimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.
9.	Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre.
5.	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të silllet në rast rreziku.
6.	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkohet zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkohet këshilla/informacione kur has në vështirësi.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre.
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
3.	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon, gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
4.	Gjen të përbashkëta dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
6.	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anashjella në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
1.	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan ndershëm, si dhe menaxhon emocionet e veta, si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
3.	Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si: shkrim, vizatim etj.) me ushqimet që i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
4.	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
6.	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
1.	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
2.	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
3.	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
4.	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
5.	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan, përmes formave të ndryshme të shprehjes, kontributin individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
7.	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi/ja apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

Rezultatet e të nxënit të fushës Jeta dhe puna **Shkalla 1**

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHTËSITË që zhvillohen	
1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet	
Nxënësi/ja:	
1.	Përshkruan ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet aktiviteteve që bëhen në shtëpi, në shkollë dhe në klasë.
2.	Zbaton veprimtari praktike të thjeshta në familje, në shtëpi dhe në klasë, bazuar në detyrat e caktuara qartë nga mësuesi dhe nga prindërit.
2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë	
Nxënësi/ja:	
1.	Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet moshatarëve në klasë dhe në shkollë sa u përket talenteve, intereseve dhe prirjeve për aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.
3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme	
Nxënësi/ja:	
1.	Identifikon veglat, pajisjet dhe makinat e thjeshta të ekonomisë familjare.
2.	Identifikon veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në iniciativa personale apo të propozuara nga mbikëqyrësi ose mësuesi/ja.
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme	
Nxënësi/ja:	
1.	Përdor kompjuterin personal për komunikim fillestar.
2.	Përdor në mënyrë të sigurt TIK-un për kryerjen e detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive përmes projekteve sipas nivelit.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit	
Nxënësi/ja:	
1.	Përmes veprimeve praktike në ekonominë familjare kupton dhe përjeton faktorët që duhen marrë në konsideratë.
6. Promovimi i kushteve të sigurt për jetë dhe për punë	
Nxënësi/ja:	
1.	Identifikon rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme.
7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme	
Nxënësi/ja:	
1.	Identifikon aktivitetet dhe bartësit e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, institucion parashkollor/shkollë dhe komunitet.

8. Komunikimi në/për jetë dhe punë

Nxënësi/ja:

1. Ndjek udhëzimet gjatë aktiviteteve të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme.

9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm - mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit

Nxënësi/ja:

1. Identifikon, përshkruan dhe klasifikon materiale ricikluese bazë nga ekonomia familjare, duke i dalluar dhe renditur për përdorim të mëtejshëm.
2. Përshkruan konceptet bazë të shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë familjare.

II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen

- Toleranca;
- Respektimi i diversitetit;
- Përkushtimi;
- Qëndrimi pozitiv;
- Bashkëpunimi;
- Respektimi i kodit të mirësjelljes;
- Respektimi rregullor;
- Gatishmëria;
- Siguria;
- Pavarësia në mendime dhe në veprime;
- Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme;
- Besimi në përdorimin e TIK-ut;
- Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit;
- Gatishmëria për bashkëpunim.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

- Njeh veten dhe të tjerët;
- Tregon për veten, për familjen dhe për mjedisin;
- Identifikon rreziqet e ndryshme;
- Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative;
- Shkëmben përvojat;
- Demonstron sjellje, veprime, shprehje;
- Praktikon ushtrime;
- Ndërton bashkëpunim;
- Vendosmëria.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Jeta dhe puna **Klasa 2**

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1 (Klasa e II).	
	PERIUDHA I		PERIUDHA II	PERIUDHA III		
	Shtator—tetor	Nëntor—dhjetor	Janar—shkurt—mars	Prill—maj—qershor		
Shkathësi për jetë	Materialet dhe përpunimi i tyre (6 orë)	Trafiku (4 orë)	Planifikimi (5 orë)	Mjedisi dhe shëndeti (2 orë)	I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8
	Trafiku (2 orë)	Profesionet (4 orë)	Mjedisi dhe shëndeti (7 orë)	Mediet (6 orë)	II	Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ 3, 4, 5, 7, 8
		Planifikimi (1 orë)			III	Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7
					IV	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6
					V	Kompetenca personale - Individ i shëndoshë 1, 3, 4, 5, 6, 7
					VI	Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7
	8 orë	9 orë	12 orë	8 orë		

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: II

Temat mësimore: Materialet dhe përpunimi i tyre;
Trafiku.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar, gjatë diskutimit në grup, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
I.7	Përshkruan në formë të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.3	Ndërtton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluar, duke u mbështetur në imagjinatën e tij.
II.4	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitën që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvlerësinë midis tyre.
II.5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njëres prej tyre në njërin nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letër, plastelinë, shkopinjë, ngjyrat, numëroren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë.
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.5	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përpunimin e vet në një detyrë/aktivitet, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkohet zgjidhjen e problemit të dhënë.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkohet detyrë/aktivitet, kur has në vështirësi.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialat dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.3	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialat, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.3	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
VI.7	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi/ja apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

2.1	Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet moshatarëve në klasë dhe në shkollë sa u përket talenteve, intereseve dhe prirjeve për aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.
6.1	Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë Identifikon rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme.
8.1	Komunikimi në/për jetë dhe për punë Ndjek udhëzimet gjatë aktiviteteve të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Materialet dhe përpunimi i tyre	- Përkruan vetitë elementare të materialeve nga jeta e përditshme dhe mënyrat e përpunimit të tyre. - Emërton materialet sipas llojit, ngjyrës etj. - Krahason llojlojshmërinë e vetive të materialeve për përdorim të veçantë.	- Materialet dhe përpunimi i tyre; - Vetitë e materialeve; - Llojet e materialeve; - Krahasoni i materialeve; - Ndryshimi i formës së gjësendeve të përbëra nga materialet e ndryshme; - Punë praktike - Punimi i mbajtës së lapsave; - Rregullat e trafikut; - Roli i policit në rrugë.	8	- Diskutimi dhe të nxënët bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe më të gjithë nxënësit); - Mësimdhënie përmes vizualizimit, demonstrimit dhe eksperimentit; - Mësimdhënie dhe të nxënët përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; - Ushtrimet me luajtje rolesh; - Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathtësive, puna interaktive; - Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.	- Buletini i pjesëmarrjes; - Lista e kontrollit; - Portfolio; - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; - Vlerësimi përshkrues; - Projekte.	- Njeriu dhe natyra; - Gjuhë shqipe; - Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; - Çështjet ndërkurrikulare; - Edukimi për qytetari demokratike; - Edukimi për paqe; - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	- Tekstet shkollore; - Librat e aktiviteve dhe të ushtrimeve; - Librat e punës; - Broshura; - Atlase; - Enciklopedi; - Gazeta; - Revista; - Doracakë; https://emesimi.rks-gov.net/shq/
Trafiku	- Zbaton punën praktike me mjete dhe materiale të ndryshme. - Njeh në mënyrë të vetdijshme rregullat e trafikut. - Përkruan rolin e policit në rrugë.						

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: II

Temat mësimore: Trafiku;
Profesionet;
Planifikimi.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv

I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar me parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.5	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njëres prej tyre në njërin nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat, numëratoren etj. për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton përzgjedhjen që ka bërë;
III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.1	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre.
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.6	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
VI.3	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
VI.5	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan, përmes formave të ndryshme të shprehjes, kontributin individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
VI.7	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilat kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.	Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet Përshkruan ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet aktiviteteve që bëhen në shtëpi dhe në shkollë. Zbaton veprimtari praktike të thjeshta në familje, në shtëpi dhe në klasë, bazuar në detyrat e caktuara qartë nga mësuesi dhe nga prindërit.
3.	Kuptimi dhe përdormi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme Përdor veglat, mjetet dhe materialet e sigurta dhe adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në iniciative personale apo të propozuara nga mbikëqyrësi ose mësuesi.
4.	Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme Përdor në mënyrë të sigurt TIK-un për kryerjen e detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive përmes projekteve sipas nivelit
5.	Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit. Përmes veprimeve praktike në ekonominë familjare kupton dhe përjeton faktorët që duhen marrë në konsideratë.
6.	Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë Identifikon rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme.
7.	Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme Identifikon aktivitetet dhe bartësit e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, institucion parashkollor, shkollë dhe komunitet.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënës për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Trafiku	- Dallon llojet e trafikut. - Zbaton në vazhdimësi rregullat e këmbësorëve. - Identifikon dhe emërton shenjat e komunikacionit - Emërton personat e rrethit të tij lidhur me profesione të ndryshme. - Përkthyer profesione të ndryshme nga jeta e përditshme. - Shpreh dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm. - Demonstron me vegla të ndryshme që lidhen me profesione të caktuara. - Tregon për përgjegjësitë që ka në familje lidhur me planifikimin.	9. Llojet e trafikut; 10. Zbatimi i rregullave të këmbësorëve; 11. Shenjat e komunikacionit; 12. Modelojmë shenjat e komunikacionit; 13. Llojet e profesioneve; 14. Përkthimi i profesioneve; 15. Emërtimi i profesioneve dhe i mjeteve të duhura; 16. Lojë në grupe; 17. Si ta organizojmë festën e ditëlindjes?	9	Diskutimi dhe të nxënësit në bashkëpunim (në grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); Mësimdhënie përmes vërtetimit, demonstrimit dhe eksperimentit; Mësimdhënie dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; Ushtrimet me luajtje rolesh;	Buletini i pjesëmarrjes; Lista e kontrollit; Portfolio; Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; Vlerësimi përshkrues; Projekte.	Njeriu dhe natyra; Gjuhë shqipe; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Çështjet ndërkurrikulare;	Tekstet shkollore; Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve; Librat e punës; Broshura; Atlase; Enciklopedi; Gazeta; Revista; Doracakë; https://emesim.rks-gov.net/shq/
Profesionet							
Planifikimi							

Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathësie, puna interaktive;
 Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna

Klasa: II

Temat mësimore: Planifikimi;
Mjedisi dhe shëndeti.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar me parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.2	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
I.3	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar, gjatë diskutimit në grup, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
I.6	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është e përshtatshme për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
I.7	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore, si dhe e prezanton para të tjerëve.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.7	Ndërton tekste, objekte apo animacione, sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë, në njërin nga format e të shprehurit.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
III.7	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe kërkon këshilla/informacione kur has në vështirësi.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.2	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.3	Gjen të përbashkëta dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njëres nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
IV.6	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anashjellas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron.
V.4	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
VI.4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.	Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet Përshkruan ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet aktiviteteve që bëhen në shtëpi dhe në shkollë. Zbaton veprimtari praktike të thjeshta në familje, në shtëpi dhe në klasë, bazuar në detyrat e caktuara qartë nga mësuesi/ja dhe nga prindërit.
5.	Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit Përmes veprimeve praktike në ekonominë familjare kupton dhe përjeton faktorët që duhen marrë në konsideratë.
6.	Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë Kupton rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme.
9.	Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit Identifikon dhe klasifikon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare, duke i dalluar, duke i krahasuar dhe duke i renditur për përdorim të mëtejshëm.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit		Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Planifikimi	- Tregon për përgjegjësitë që ka në familje lidhur me planifikimin.	18. Nxënësit rregullojnë klasën;	12	Diskutimi dhe të nxënësit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);	Buletini i pjesëmarrjes;	Njeriu dhe natyra;	Tekstet shkollore; Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve;	Burimet
	- Përkruan mënyrën e planifikimit dhe të vendimmarrjes në shtëpi, në shkollë.	19. Tregim - Klasa humanitare;						
Mjedisi dhe shëndeti	- Diskuton për të ardhurat dhe shpenzimet bashkë me familjen.	20. Çfarë duhet ditur për kursimet në familje?	12	Diskutimi dhe të nxënësit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);	Lista e kontrollit;	Gjuhë shqipe;	Librat e punës; Broshura; Atlase;	Burimet
	- Njeh dhe zbaton në vazhdimësi e në mënyrë të vetëdijshme rregullat e higjienës, duke u kujtuar kujdes vetes, të tjerëve, mjedisit në shkollë dhe në shtëpi.	21. Planifikimi i kursimit në familje;						
	- Përkruan mënyrën e veprimit me rastin e paraqitjes së ndonjë sëmundjeje.	22. Planifikimi familjar - Lojë skenike;						
	- Përkruan veprimet që kryhen për mbrojtjen e pastërtisë individuale, ambientit, klasës, shkollës dhe mjedisit përreth.	23. Zbatimi i rregullave të higjienës dhe kujdesit për veten;						
	- Demonstron klasifikimin e mbeturinave sipas llojit të materialit.	24. Rregulla të tjera për mbajtjen e higjienës personale, të mjedisit në shtëpi dhe shkollë;						
	- Emërton shkaktarët e ndotjes së ambientit.	25. Higjiena personale;						
		26. Mënyra e veprimit me rastin e paraqitjes së ndonjë sëmundjeje;						
		27. Veprimet që kryhen për mbajtjen e pastërtisë;						
		28. Pastërtia e mjedisit që ju rrethon;						
		29. Klasifikimi i mbeturinave sipas llojit dhe materialit.						

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Shkathtësi për jetë

Fusha e kurrikulës: Jeta dhe puna
Temat mësimore: Mjedisi dhe shëndeti;
Mediet.

Klasa: II

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
I.1	Lexon me zë një tekst të palexuar me parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
I.2	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
I.4	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
I.4	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është i përshtatshëm për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
I.8	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo interpretimit të një kënge apo melodie, në njërin nga format shprehëse.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.8	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
-------------	--

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.2	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohej prej tij/saj.
III.3	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit.
III.4	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
III.6	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
IV.2	Kontrollon mjetet/materialat dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
IV.3	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
IV.5	Identifikon burimet e nevojshme (materialat, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
IV.6	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta dhe anashjella në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
V.1	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjëseneve personale) dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron.
V.3	Bën një listë (me njërin nga format shprehëse, si: shkrim, vizatim etj.) me ushqimet që i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
V.4	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
V.5	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
VI.2	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
VI.3	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
VI.4	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
VI.6	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
V.7	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.	Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet Përshkruan ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet aktiviteteve që bëhen në shtëpi dhe në shkollë. Zbaton veprimtari praktike të thjeshta në familje, në shtëpi dhe në klasë, bazuar në detyrat e caktuara qartë nga mësuesi/ja dhe nga prindërit.
2.	Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë Dallon ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet moshatarëve në klasë dhe në shkollë sa u përket talenteve, intereseve dhe prirjeve për aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.
6.	Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë Kupton rregullat për mbrojtje dhe siguri, dallon rreziqet në jetën e përditshme.
4.	Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme Përdor kompjuterin personal për komunikim fillestar. Përdor në mënyrë të sigurt TIK-un për kryerjen e detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathtësive përmes projekteve sipas nivelit.
9.	Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit Identifikon dhe klasifikon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare, duke i dalluar, duke i krahasuar dhe duke i renditur për përdorim të mëtejshëm.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet	
Mjedisi dhe shëndeti	- Demonstron klasifikimin e mbeturinave sipas llojit të materialit. - Emërton shkaktarët e ndotjes së ambientit. - Dallon disa lloje mediesh dhe liston emisionet e TV-së në bazë të moshës përkatëse. - Luan rolin e moderatorit gjatë aktiviteteve brenda klasës. - Diskuton me grupin për përmbajtjen e revistës për fëmijë. - Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe të skicuara.	30. Shkaktarët e ndotjes së ambientit; 31. Frutat dhe perimet; 32. Mediet dhe llojet e tyre; 33. Mjetet e informimit; dhe programet e parqyera; 34. Lojë skenike - Rinori dhe Alba; 35. Lojë skenike - Rinori dhe Alba (përsëritje); 36. Fletushka e klasës; 37. Fletushka e klasës - Punë në grupe.	8	Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit); Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit; Mësimdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit; Ushtrimet me luajtje rolesh; Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimi i njohurive dhe shkathërsive, puna interaktive; Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.	Buletini i pjesëmarrjes; Lista e kontrollit; Portfolio; Vëzhgimi i drejtpërdrejtë; Vlerësimi përshkrues; Projekte.	Njeriu dhe natyra; Gjuhë shqipe; Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti; Çështjet ndërkurrikulare; Edukimi për qytetari demokratike; Edukimi për paqe; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.	Tekstet shkollore; Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve; Librat e punës; Broshura; Atlase; Enciklopedi; Gazeta; Revista; Doracakë; https://emesimi.rks-gov.net/shq/
Mediat							

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Përshkruan vetitë e materialeve nga jeta e përditshme dhe mënyrat e përpunimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 8.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton sende të ndryshme në klasë;
- Grupon sende nga i njëjti material;
- Gjen materialet e sendeve të emërtuara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, lapsa me ngjyra, fletë A4, video-projektor (opsionale), gjëra të ndryshme që mund të gjenden në klasë (vizore, lapsa, libra, fletore).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit që të shikojnë përreth tyre dhe të emërtojnë sa më shumë sende që shohin. U rikujtohet që gjërat që na rrethojnë janë të punuara nga materiale të ndryshme. Nxiten nxënësit të përmendin disa nga këto materiale të mësuara në klasë të parë. Materialet e përmendura shënohen në tabelë.

Hapi 2: Ndërkohë që nxënësit kanë përmendur materialet, ato janë shënuar në tabelë. Kërkohet nga ta që t'i grupojnë gjërat nga i njëjti material.

Materialet dhe përpunimi i tyre
 Gjërat që na rrethojnë janë punuar nga materiale të ndryshme.

Për shembull, materiale janë: letra, guri, druri, xhami, metali, goma, plastika, tekstili dhe lëkura.



Prej këtyre materialeve punohen gjëra të shumta. Çdo material ka veti të caktuara.



Materialet dhe përpunimi i tyre

Gjërat që na rrethojnë janë punuar nga materiale të ndryshme.

Për shembull, materiale janë: letra, guri, druri, xhami, metali, goma, plastika, tekstili dhe lëkura.



Prej këtyre materialeve punohen gjëra të shumta. Çdo material ka veti të caktuara.



7

Nga letra

Nga druri

Nga metali

Nga plastika

Nga xhami

Fillimisht, nxënësit punojnë individualisht në fletore, më pas së bashku plotësohen edhe diagramet në tabelë. Ata i kontrollojnë dhe i plotësojnë diagramet me mendimet e shokëve a shoqeve.

Hapi 3: Nxiten nxënësit që në dyshe të bisedojnë për gjërat e grupuara sipas materialeve të njëjta ose me veti të njëjta. Kërkohej nga ta që të gjejnë edhe materiale të tjera që nuk janë përmendur më parë.

Parashtrihen pyetjet:

- Sa lloje të materialeve keni gjetur?
 - Cili material është më i pranishëm në klasën tonë?
 - Si dallojnë në mes vete këto materiale?
- Përgjigje të mundshme mund të jenë: *Sipas llojit, ngjyrës, fortësisë, lakueshmërisë etj.*
- A mund të gjeni edhe sende të tjera që janë punuar nga disa materiale? Emërtoni disa prej tyre.

Përgjigje të mundshme mund të jenë: *Banka nga druri dhe metali; dera nga druri dhe xhami; tabela nga druri; metali dhe plastika etj.*

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin, emërtimin dhe grupimin e materialeve të ndryshme.

Detyrë:

Gjen në shtëpi të paktën pesë gjëra me materiale të ndryshme dhe shkruan nga cili material janë ndërtuar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan vetitë e materialeve nga jeta e përditshme dhe mënyrat e përpunimit të tyre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 8.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vetitë e materialeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton sendet e ndërtuara nga materialet e ndryshme;
- Përshkruan vetitë e materialeve;
- Klasifikon sendet sipas materialit të njëjtë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, lapsa me ngjyra, fletë A4, gazeta, gotë qelqi, shishe plastike, çelës metal, gomë, rroba, portofol etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Përpara nxënësve paraqiten sende të ndryshme të punuara nga materiale të llojllojshme.




Nxiten të emërtojnë këto sende dhe materialet nga të cilat janë të punuara.



—Guri—

Vetitë e gurit janë:
i fortë,
i rëndë,
i ngurtë.

Guri përpunohet prej
shkëmbinjve.



10

Hapi 2: Nxënësit e ndarë në grupe të vogla vazhdojnë punën me tekst.

Grupi i parë: Mësojnë vetitë e letrës dhe të gurit, gjejnë sa më shumë sende të punuara nga letra dhe guri dhe tregojnë prej kujt përfitohen.

Grupi i dytë: Mësojnë vetitë e drurit dhe të xhamit, nga çka përpunohen dhe për çka përdoren.

Grupi i tretë: Mësojnë vetitë e metalit dhe të gomës, nga çka përpunohen dhe për çka përdoren.

Grupi i katërt: Mësojnë për vetitë e plastikës dhe të tekstilit, nga çka përpunohen dhe për çka përdoren.

Grupi i pestë: Mësojnë për vetitë e lëkurës, ku e marrim dhe për çfarë përdoret. Gjetjet prezantohen përpara klasës.

Hapi 3: Pas prezantimit nga secili grup, nxënësit vazhdojnë punën në mënyrë individuale. Secili nxënës përpiqet të gjejë dhe të klasifikojë sa më shumë sende të punuara nga i njëjti material.

Letra	Guri	Druri	Metali	Goma	Plastika	Xhami	Lëkura	Tekstili

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin e vetive dhe klasifikimin e gjërave nga materiali i njëjtë.

Detyrë:

Gjen dhe vizaton nga dy sende prej secilit material të mësuar në klasë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Emërton materialet sipas llojit, ngjyrës etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 8.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet e materialeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton llojet e materialeve sipas formës, ngjyrës etj.;
- Krahason materialet sipas masës, temperaturës etj.;
- Përshkruan vetitë e materialeve në të tri gjendjet agregate.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, lapsa me ngjyra, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Shënohen në tabelë fjalët *formë, ngjyrë, gjendje agregate, madhësi, masë, temperaturë*. Nxiten nxënësit të mendojnë se çfarë u kujtojnë këto fjalë. Ndërkohë bëhen pyetje: Gjërat që i kemi përreth si dallojnë? Emërtoni disa gjëra që dallojnë për nga ngjyra, forma, madhësia etj. Nxënësit sjellin shembuj të ndryshëm, duke e bërë dallimin sipas kërkesave.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrat dhe kërkesat në tekst.

Ushtrimi 1: Emërtojnë sipas formës topin, tullën dhe gurin. Tregojnë cili ka formë të rregullt.

Ushtrimi 2: Emërtojnë ngjyrat e pemës, të robotit dhe të këmishës.

Ushtrimi 3: Emërtojnë gjësende në tri gjendje agregate. Dallojnë vetitë e këtyre trupave.

Materialet dhe përpunimi i tyre

LLOJET E MATERIALEVE

Materialet në natyrë dallohen sipas formës, ngjyrës, madhësisë, peshës, temperaturës, gjendjes agregate (e lëngët, e ngurtë dhe e gaztë) dhe elasticitetit.

Sipas formës:

Emërto formën		
		

Vështroni në shtëpi disa nga gjësendet të cilat janë materiale me forma të ndryshme.


Emërto gjësendin	Përshkruaj formën e tij

Materialet dhe përpunimi i tyre

Shkruaj nga tri gjësende për të trija gjendjet agregate:

Sipas madhësisë dhe peshës:

shkruaj emrat e gjësendeve, të paraqitura më poshtë, duke filluar nga më e vogla deri të më e madhja (dalloji me numra 1, 2, 3).



Cili nga këto dy gjësende peshon më rëndë?



9

Ushtimi 4: Emërtojnë dhe krahasojnë gjëra sipas madhësisë dhe masës.

Ushtimi 5: Emërtojnë llojet e materialeve dhe tregojnë për çfarë përdoren.

Pasi të kenë përfunduar detyrat, shkëmbejnë tekstet, krahasojnë punën e tyre me të shokut/shoqes së bankës dhe plotësojnë me ndonjë të dhënë.

Hapi 3: Nxënësit nxiten të dallojnë materialet sipas gjendjes agregate. Kërkohet nga ta të gjejnë sa më shumë shembuj me gjëra të ndryshme që i hasin në shkollë ose shtëpi.

Të lëngëta	Të ngurta	Të gazta

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin, emërtimin, krahasimin e materialeve sipas llojit dhe përshkrimin e tri gjendjeve agregate.

Detyrë:

Në fletore pune (faqe 11) shkruan llojet e materialeve në hapësirat e dhëna.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Krahason llojllojshmërinë e vetive të materialeve për përdorim të veçantë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, II.4, III.2, IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 8.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahasimi i materialeve

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Tregon gjendjen agregate të gjërave;
- Dallon vetitë e materialeve në të tri gjendjet agregate;
- Klasifikon gjërat sipas gjendjes dhe vetive.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, lapsa me ngjyra, fletë A4, shishe me ujë, gur, balonë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Përpara nxënësve prezantohet një gur, shishe me ujë dhe një balonë e fryrë. Nxiten që të tregojnë për formën, masën dhe gjendjen agregate të këtyre gjësedeve. Hapet diskutimi rreth pyetjes: Çfarë gjendje agregate kanë lëndët dhe si dallojnë mes vete?



Lëngjet mund të rrjedhin lirshëm. Ato marrin formën e enës në të cilën ndodhen. Gazet marrin formën e trupit që mbushin.



27

Hapi 2: Nxënësit në grupe plotësojnë tabelën e përgatitur paraprakisht. Kërkohej që të vizatojnë në hapësirën përkatëse disa gjëra sipas gjendjes agregate.

Gjërat e ngurta ruajnë formën edhe nëse hidhen.	Lëngjet lëvizin lirshëm, marrin formën e enës që mbushin.	Gazet marrin formën e enës që e mbushin.

Hapi 3: Punimet e nxënësve vendosen në këndin e ekspozitës. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Nxënësit e tjerë mund të bëjnë pyetje të tilla, si:

- Çfarë keni vizatuar?
- Nga çfarë materiali janë ndërtuar? Çfarë vetish kanë këto materiale?
- Cilat janë disa nga vetitë e trupave të ngurtë?
- Cilat janë vetitë e lëngjëve?

Përgjigje të mundshme të nxënësve mund të jenë: *Shishja është ndërtuar nga plastika ose xhami; karriget nga druri; vizorja nga plastika etj.*

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për kontributin në grup, përshkrimin e vetive të gjërave dhe klasifikimin në tri gjendje agregate.

Detyrë:

Në faqen 29, të vendosen në hapësirat e rrethëve emrat e gjësedeve sipas vetive të tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathhtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krahason llojllojshmërinë e vetive të materialeve për përdorim të veçantë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, II.4, III.2, IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 8.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndryshimi i formës së gjësendeve të përbëra nga materialet e ndryshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon ndryshimet që pësojnë materialet;
- Tregon faktorët që ndikojnë në këto ndryshime;
- Demonstron veprime të ndryshimit të materialeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, lapsa me ngjyra, flipçart, fletë A4, llastik, top, vizore, gomë, kapëse, litar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Përpara nxënësve prezantohen sende të ndryshme.



Rikujtohet se nga cili material janë ndërtuar secila nga këto. Hapet diskutimi rreth pyetjeve: Cilat janë vetitë e këtyre materialeve? Çfarë ngjyre kanë? Çfarë gjendje agregate kanë?

Materialet dhe përpunimi i tyre NDRYSHIMI I FORMËS SË GJËSENDEVE TË PËRBËRA NGA MATERIALET E NDRYSHME

Janë dhënë disa gjësende të prodhuara nga materiale të forta.



Për ta ndryshuar formën e tyre përdoren katër mënyra: shtypja, tërheqja, përkulja dhe përdredhja.

Materialet dhe përpunimi i tyre

- Llastiku mund ta ndryshojë formën duke e tërhequr.
- Topi mund ta ndryshojë formën duke e shtypur.
- Vizorja mund ta ndryshojë formën duke e përkulur.
- Goma mund ta ndryshojë formën duke e përdredhur.
- Kapesja mund ta ndryshojë formën duke e përkulur.
- Litari mund ta ndryshojë formën duke e përdredhur.

Provoji këto veprime me gjësendet e përmendura. Trego pastaj, a ndryshoi forma e tyre.

Vazhdo të gesh gjësende të tjera, të cilave mund t'ua ndryshosh formën përmes veprimeve të ndryshme.

31

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen ta lexojnë tekstin në mënyrë individuale. Më pas, hapet diskutimi dhe demonstronhet secila situatë e përmendur nga ta. Edhe nxënësit provojnë të ndryshojnë formën e këtyre gjësendeve duke përdorur katër mënyrat: shtypjen, tërheqjen, përdredhjen dhe përkuljen.

Në bashkëpunim me nxënësit, plotësohet tabela e përgatitur në flipçart ose tabelë.

Llastiku ndryshon formën duke...	Topi ndryshon formën...	Vizorja ndryshon formën...
Goma ndryshon formën...	Kapësja ndryshon formën...	Litari ndryshon formën...

Hapi 3: Nxënësit, në dyshe, gjejnë shembuj të tjerë të gjësendeve, të cilave mund t'ua ndryshojnë formën me njërin nga veprimet e përmendura.

Dini ndonjë material tjetër që ndryshon formën duke e tërhequr?

Dini ndonjë material tjetër që ndryshon formën duke e shtypur?

Nxënësve u kërkohet të gjejnë në klasë dy gjëra që ndryshojnë formën duke u përdredhur. Gjetjet i prezantojnë përpara klasës edhe me veprimtari praktike.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin e ndryshimit të formës së gjërave, për gjetjen e shembujve konkretë dhe demonstrimin e ndryshimit të materialeve.

Detyrë:

Në fletore pune (faqe 13) plotëson fjalëkryqin me fjalët e dhëna.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Materialet dhe përpunimi i tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Zbaton punën praktike me mjete dhe materiale të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.4, III.2, IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 8.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Punë praktike - Punimi i mbajtëses së lapsave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Planifikon veprimtarinë dhe përgatit materialet e nevojshme;
- Përdor mjetet e punës;
- Modelon mbajtësen e lapsave nga kartoni.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Vizore, ngjitës, gërshërë, laps, letër me ngjyra, karton etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Fillimisht kërkohet nga nxënësit ta organizojnë me kujdes vendin e punës, t'i përgatitin materialet dhe mjetet e nevojshme, ta kenë parasysh që mjetet e punës duhen përdorur me kujdes, sepse në këtë mënyrë do të krijojnë kushte për punë të sigurt dhe cilësore. Përzgjedhin modelin që do të punojnë me materialet e përgatitura.

Hapi 2: Udhëzohen nxënësit ta shikojnë vizatimin dhe ta lexojnë udhëzimin në tekst përpara se të fillojnë me punën. Përcaktohen për modelin që do të punojnë. Modelet nga letra dhe kartoni punohen dhe ndërtohen duke ndjekur udhëzimet hap pas hapi.



Materialët dhe përpunimi i tyre



Modeli 1



Modeli 2



Hapi 3: Gjatë punës, nxënësit evidentojnë ndryshimin e formave të materialeve të përdorura.

Cili material ishte më i përshtatshëm për të punuar? Pse?

Pas veprimtarisë, vendi i punës çdoherë duhet pastruar. Punimet e nxënësve ruhen në klasë për t'i sistemuar lapsat dhe ngjyrat.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet kujdesi në përdorimin e mjeteve të punës, estetika e modeleve të përfunduara dhe përgatitja e hapësirës punuese.

Detyrë:

Punon edhe modelin tjetër të mbajtëses, për t'i sistemuar lapsat në shtëpi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Trafiku

Rezultatet e të nxënit të temës:

Njeh në mënyrë të vetëdijshme rregullat e trafikut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.5, III.1, III.3, VI.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Rregullat e trafikut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Respekton rregullat e këmbësorëve në trafik;
- Dallon shenjat e komunikacionit dhe i respekton ato;
- Përshkruan rregullat e sjelljes në mjete të transportit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4 me ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Udhëzohen nxënësit të mendojnë se si veprojnë gjatë rrugës shtëpi-shkollë. Hapet diskutimi rreth pyetjeve: Me çka keni ardhur në shkollë? Si veproni në raste kur nuk jeni të shoqëruar nga të rriturit? Tregoni si silleni gjatë kësaj kohe. Çfarë bëni kur kaloni rrugën? Cilat rregulla respektoni?

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen ta hapin tekstin dhe t'i përshkruajnë ilustrimet. Më pas paraqitet para nxënësve tabela e përgatitur me disa situata dhe këshilla. Kërkohej nga ta të japin mendime dhe të sqarojnë pse duhet vepruar në këtë mënyrë. Tabela plotësohet gjatë diskutimit.

RREGULLAT E TRAFIKUT

Trafiku

Ne shohim automjete duke qarkulluar kur shkojmë në shkollë ose diku tjetër. Duhet pasur kujdes kur automjetet ose mjetet e tjera të transportit kalojnë pranë nesh. Kështu, ne duhet gjithmonë t'i respektojmë rregullat e sigurisë në trafik, si vijon:



Trafiku

Rregullat e sigurisë
se trafikut

Respektoni këto rregulla
gjatë qarkullimit!

2.

Në gjithmonë duhet të ecim në
anën e majtë të rrugës!



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për dallimin dhe respektimin e rregullave në trafik për këmbësorë dhe automjete.

Detyrë:

Në fletore pune (faqe 19), përshkruan me fjali ngjarjen e paraqitur në figurë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Duhet të ecim në trotuar.	Duhet të ecim në anën e majtë të rrugës.	Nuk duhet të luajmë në rrugë.	Duhet t'i respektojmë shenjat e trafikut.	Në autobus, nuk duhet të hyjmë ose dalim nëse është duke lëvizur.

Hapi 3: Më ndihmën e videoprojektorit, paraqiten dy situata kur nuk respektohen rregullat e qarkullimit rrugor. Kërkohej nga nxënësit të komentojnë mosrespektimin e rregullave të trafikut.

Po ju, si silleni në situata të tilla?



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Trafiku

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan rolin e policit në rrugë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.5, III.1, III.3, VI.3, VI.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Roli i policit në rrugë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Respekton shenjat e komunikacionit;
- Përshkruan rolin e policit rrugor;
- Përshkruan rregullat e sjelljes në rrugë.


Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4 me ngjyra, semafor nga kartoni ose lodër, shenja stop etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shkruhen në mes të tabelës fjalët “Policë rrugor”. Kërkohej nga nxënësit të tregojnë gjithçka që dinë për punën e policëve rrugorë. Parashtrihen pyetjet: A keni takuar ndonjëherë policë rrugor? Si kanë vepruar? Për çka i shërben shenja “Stop” policit rrugor? Mendimet e tyre shënohen dhe diskutohet rreth tyre.



ROLI I POLICIT NË RRUGË

Trafiku

Një polic na ndihmon që ne të kalojmë rrugën dhe të jemi të sigurt gjatë qarkullimit.



Ai shpeshherë e ndalon qarkullimin e automjeteve, në mënyrë që ne të mund ta kalojmë rrugën.

39

Trafiku

Policja lajmëron ndihmën e shpejtë që të vijë në vendin ku është shkaktuar aksidenti.

194



40

Hapi 2: Paraprakisht janë përgatitur disa pajisje që përdoren nga polici rrugor. Improvizohen para nxënësve disa situata me pjesëmarrjen e tyre aktive.

Situata e parë - ndihma e policit për të kaluar rrugën.	Situata e dytë - polici ndalon qarkullimin e automjeteve për të kaluar rrugën fëmijët.	Situata e tretë - policja lajmëron ndihmën e shpejtë nëse ka ndodhur aksidenti.

Hapi 3: Në mënyrë individuale, nxënësit formojnë një pesëvargësh për policin.

Polici

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin e rolit të policit rrugor, respektimin e shenjave të komunikacionit dhe pjesëmarrjen aktive në veprimtari.

Detyrë:

Në fletore pune (faqe 20), tregon si vepron në situata të ngjashme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II
Tema: Trafiku

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Dallon llojet e trafikut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1, II.5, III.1, III.3, VI.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet e trafikut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton llojet e ndryshme të trafikut;
- Përshkruan mënyrën e qarkullimit të këtyre mjeteve;
- Paraqet mjetet e qarkullimit, sipas llojit, me vizatim.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Para nxënësve paraqiten disa fotografi. Kërkohej prej tyre që t'i emërtojnë ato.




Hapet diskutimi rreth pyetjeve: Me cilat nga këto mjete keni udhëtuar? Tregoni si ka qenë udhëtimi. Cili mjet i udhëtimit të pëlqen më shumë? Pse?

Hapi 2: Lexohet teksti pjesë-pjesë dhe, pas çdo pjese të lexuar, parashtrohen pyetje.

Pjesa e parë: Për çfarë shërbejnë treni, aeroplani dhe anija? Kush bën pjesë në qarkullim ajror dhe kush

LLOJET E TRAFIKUT

Trafiku



Treni, aeroplani dhe anija shërbejnë për të bartur njerëz dhe mallra në largësi të mëdha.

Automobili dhe motoçikleta zakonisht përdoren për të udhëtuar në distanca më të vogla. Këto mjete përdorin lëndë djegëse për t'i venë në punë motoret. Disa prej mjeteve përdorin edhe motore elektrike. Bicikleta po ashtu shërben për të levizur në distanca të vogla. Ajo vihet në lëvizje përmes rrotullimit të pedaleve me këmbë.

41

LLOJET E TRAFIKUT



Llojet e trafikut:	Mjetet e qarkullimit të trafikut:
ajror	aeroplani, helikopteri
ujor	
tokësor	

Në bazë të figurës, ndaj llojet dhe mjetet e trafikut.

Të formojmë një pesëvargësh për trafikun.

22

Punimet e pjesëtarëve të secilit grup ngjiten në flipçart dhe vendosen në këndin e ekspozitës. Nxënësit e grupeve të tjera japin sugjerime për mjete të tjera që mund të shtohen në grupin përkatës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin, përshkrimin dhe paraqitjen e mjeteve të transportit të njerëzëve dhe të mallrave.

Detyrë:

Në fletore pune (faqe 22), në bazë të figurave, i klasifikon mjetet e trafikut sipas llojit. Formon një pesëvargësh.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:


në ujqor? Si quhet rruga nëpër të cilën qarkullon treni?

Pjesa e dytë: A është e përshtatshme që të udhëtojmë në rrugë të gjata me motoçikletë? Pse?


Pjesa e tretë: Tregoni si bëhet e mundur që të qarkullojnë këto mjete. Cila lëndë djegëse përdoret për makina, aeroplanë, motoçikleta? Po biçikletës, a i duhet lëndë djegëse për të qarkulluar? Pse? Shpjegohet si vihet në lëvizje ajo. Në fund hartohet një listë me rregulla se si duhet mbrojtur mjedisi nga tymi i makinave dhe mjeteve të tjera të trafikut.

Hapi 3: Nxënësit, të ndarë në grupe, vizatojnë sipas llojit mjetet e transportit tokësor, ajror dhe ujqor.


Grupi i parë



Grupi i dytë



Grupi i tretë



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Trafiku

Rezultatet e të nxënit të temës:

Zbaton në vazhdimësi rregullat e këmbësorëve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, II.5, III.2, III.3, VI.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Zbatimi i rregullave të këmbësorëve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Zbaton rregullat e këmbësorëve në trafik;
- Respekton ngjyrat e semaforit për kalim të rrugës;
- Ndhmon njerëzit që kanë nevojë gjatë kalimit të rrugës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4, semafor kartoni ose letre.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Vendosen në tabelë tri fletë A4 me ngjyrë të kuqe, të verdhë dhe të gjelbër. Pyeten nxënësit: Çfarë ju kujtojnë këto ngjyra? Ku i keni hasur ato? Çfarë domethënie ka secila prej tyre? A dini edhe ndonjë rregull tjetër të trafikut?



Hapi 2: Kujtohen edhe disa rregulla të tjera të këmbësorëve. Hapet diskutimi lidhur me shprehjet.




Trafiku

Në udhëkryq gjithmonë duhet ta kalojmë rrugën kur të ndizet ngjyra e gjelbër për këmbësorë.



Shprehje	Koment
Nëse ka mbikalim, shfrytëzoje dhe mos rreziko.	
Ndihmoji të moshuarit ta kalojnë rrugën.	
Në udhëkryq, kalo kur është e ndezur ngjyra e gjelbër në semaforin e këmbësorëve.	
Kaloje rrugën në vendkalimin e këmbësorëve.	
Mos vrapo në rrugë.	

Hapi 3: Nxënësit vazhdojnë punën në fletore pune, në faqen 19. Duke e ngjyrosur figurën e dhënë, analizojnë se sa i respekton vajza rregullat e komunikacionit. Tregojnë se si sillen ata në raste të tilla.



Parashtrohet një situatë për diskutim: A e keni parë ndonjëherë dikë që bën veprime të ngjashme në rrugë? Tregoni si silleni rrugës nga shtëpia për në shkollë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për zbatimin e rregullave të këmbësorëve, shpjegimin dhe respektimin e semaforit sipas ngjyrave.

Detyrë:

Punon një semafor duke përdorur ambalazhe të ushqimeve dhe letra me ngjyra.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna
Lënda: Shkathtësi për jetë
Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II
Tema: Trafiku

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Identifikon dhe emërtan shenjat e komunikacionit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.5, III.2, III.3, VI.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shenjat e komunikacionit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon shenjat e komunikacionit sipas llojit;
- Identifikon disa shenja që i sheh më shpesh në rrugë;
- Vlerëson rëndësinë e shenjave të komunikacionit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4, shenja komunikacioni nga kartoni ose letra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Në flipçart ose tabelë paraqiten tri figura gjeometrike, tashmë të njohura për nxënësit. Fillimisht kërkohet që të emërtohen ato dhe të mendojnë se çfarë lidhje kanë me trafikun.



Hapi 2: Pasi të jetë shpjeguar se shenjat e komunikacionit ndahen në tri grupe dhe secili ka formë të caktuar, në bashkëpunim bëhet klasifikimi i tyre.

Trafiku

SHENJAT E KOMUNIKACIONIT

Shenjat e komunikacionit ndahen në tri grupe:

- shenjat e rrezikut;
- shenjat e urdhrave të prerë;
- shenjat e lajmërimit.

Shenjat e rrezikut paralajmërojnë pjesëmarrësit në komunikacion për rreziqet që do t'i hasin në rrugë. Këto shenja kanë formë trekëndëshi.

Shenjat e urdhrave të prerë kanë formë rrethore. Ato na tregojnë: ndalim, kufizim ose detyrim.

Shenjat e lajmërimit japin informata për rrugën nëpër të cilën qarkullojmë. Këto shenja kanë formë drejtkëndëshi.

45

Trafiku

Me ndihmën e mësueses/it, identifikoni shenjat e mëposhtme.



46

Shenjat e rrezikut	Shenjat e urdhrave të prerë	Shenjat e lajmërimit
Kanë formë trekëndëshi	Kanë formë rrethore	Kanë formë drejtkëndëshi

Vizatohet dhe emërtohet një shenjë komunikacioni, të cilën nxënësit e hasin gjatë rrugës për në shkollë.

Hapi 3: Punimet e nxënësve vendosen në këndin e ekspozitës.

Secili grup i prezanton shenjat e komunikacionit që ka vizatuar dhe domethënien e tyre. Në diskutim përfshihen edhe nxënësit e tjerë, të cilët parashtrojnë pyetje për shokët a shoqet e tyre.

Prezantimi vazhdohet edhe nga grupet tjera.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen dhe identifikimin e shenjave sipas grupimeve, për dallimin e formës së tyre dhe vlerësimin e shenjave të komunikacionit.

Detyrë:

Në fletore pune (faqe 25) e plotëson fjalëkryqin me figurat e dhëna.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:



Hapi 3: Pas përfundimit të aktivitetit, vazhdohet puna me tërë klasën. Bëhet një përmbledhje e njohurive të fituara nga orët e kaluara. Të gjitha përmbledhen në Diagramin e Venit. Shkruajnë çfarë kanë të përbashkët dhe të veçantë.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen dhe shpjegimin e shenjave të komunikacionit dhe punën praktike të realizuar individualisht për modelin e shenjave.

Detyrë:

Punon me karton nga një shenjë rreziku, urdhri dhe lajmërimi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Profesionet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton personat e rrethit të tij lidhur me profesione të ndryshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2, 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llojet e profesioneve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon profesione të ndryshme në rrethin e tij;
- Emërton profesionet e anëtarëve të familjes;
- Shpreh se çfarë dëshiron të bëhet kur të rritet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u parashtrohet pyetja:

- Çfarë dëshironi të bëheni kur të rriteni? Pse?

Hapet diskutimi me ta. Vazhdohet me pyetje të tjera:

- Po çfarë profesione kanë anëtarët e familjes suaj?
- Cila është puna që bëjnë ata?

Nxiten të tregojnë sa më shumë profesione që njohin dhe të tregojnë rëndësinë e tyre.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen ta hapin fletoren e punës në faqen 29 dhe, në mënyrë të pavarur, i emërtojnë profesionet e dhëna.

Nxiten të flasin për profesionet që njohin dhe të tregojnë për rëndësinë e tyre.

LLOJET E PROFESIONEVE

Profesionet



49

Profesionet

Shkruaj profesionet sipas figurave të dhëna:



Shkruaj sipas numrave të dhënë:


1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____
11. _____
12. _____

31

Tregojnë se a kanë ndonjë anëtar të familjes së tyre që ushtron ndonjë nga profesionet e paraqitura.

Nxënësit përshkruajnë se çfarë pune bëjnë ata. Vizatojnë sipas dëshirës.

Hapi 3: Në bashkëpunim me nxënësit, plotësohet pema e mendimeve.



Tregojnë çfarë dinë për këto profesione. Para-shtrohen pyetje: A mbajnë uniforma në vendin e punës? A do të doje edhe ti kur të rritesh të mbash uniformë? Pse? Mendimet e tyre shënohen në hapësirat përkatëse. Pema e mendimeve zgjerohet me propozim të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet emërtimi i profesioneve, njohja e profesioneve të ndryshme në rrethin familjar dhe mënyra e shprehjes së dëshirës për profesionin.

Detyrë:

Vizaton profesionin e parapëlqyer.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Profesionet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan profesionet e ndryshme nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2, 7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përshkrimi i profesioneve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton profesione të ndryshme në rrethin familjar;
- Përshkruan profesionet e përmendura në tekst;
- Vlerëson rëndësinë e secilit profesion.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4, burime interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Me ndihmën e videoprojektorit ose me ndihmën e ilustrimeve, paraqiten persona që lidhen me profesione të ndryshme. U shpjegohet se njerëzit kanë profesione të ndryshme. Parashtrihen pyetjet: Cilat nga këto profesione i njeh? A njeh persona që u takojnë këtyre profesioneve? Hapet diskutimi me nxënësit, ndërkohë ata i emërtojnë profesionet e paraqitura.

Hapi 2: Ndërkohë janë përgatitur etiketa me fotografi dhe përshkrim të profesionit të caktuar. Udhëzohen gjysma e nxënësve të tërheqin nga një etiketë me fotografi të profesionit dhe gjysma tjetër etiketën me përshkrim të profesionit. Nxënësit që kanë etiketat me përshkrim lexojnë me radhë përshkrimin, ndërkohë ata që kanë ilustrimin afrohen dhe në këtë mënyrë krijohen dyshet.

Profesionet

PËRSHKRIMI I PROFESIONEVE

Mjeku

Pershendetje!
Unë jam mjeku dhe detyra ime është të kujdesem për shëndetin tuaj.



Inxhinierja

Pershendetje!
Unë jam inxhinierë dhe detyra ime është të ndërtoj rrugë, shtëpi dhe ndërtesa për banim dhe punë.



50

Mësuesja

Pershendetjel
Unë jam mësuesja dhe detyra ime është t'ju mësoj të lexoni rrjedhshëm, të shkruani si duhet, të bëni llogaritje matematikore etj.



Policja

Pershendetjel
Unë jam policja dhe detyra ime është të kujdesem për sigurinë tuaj.



Nxënësve u jepen dhjetë minuta kohë që të diskutojnë dhe të kujtojnë çdo gjë që dinë për profesionin përkatës.

Hapi 3: Dyshet e krijuara prezantojnë profesionin para klasës.



Pershendetjel
Unë jam mjeku dhe detyra ime është të kujdesem për shëndetin tuaj.



Pershendetjel
Unë jam inxhinierja dhe detyra ime është të ndërtoj rrugë, shtëpi dhe ndërtesa për banorë dhe punë.



Pershendetjel
Unë jam kuzhinieri dhe detyra ime është të përgatis ushqim për ju.



Pershendetjel
Unë jam mësuesja dhe detyra ime është t'ju mësoj të lexoni rrjedhshëm, të shkruani bukur, të kryeni llogaritje matematikore etj.



Pershendetjel
Unë jam policja dhe detyra ime është të kujdesem për sigurinë tuaj.



Pershendetjel
Unë jam ushtarja dhe detyra ime është ta mbrojmë vendin.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet njohja e profesioneve, bashkëpunimi për përshkrimin e profesionit dhe rëndësinë e secilit profesion.

Detyrë:

Përshkruan profesionin e parapëlqyer.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Profesionet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpreh dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.3, IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Emërtimi i profesioneve dhe i mjeteve të duhura

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon mjetet e punës sipas profesionit;
- Klasifikon veglat e profesioneve të prezantuara;
- Shpreh dëshirën për profesionin që i pëlqen.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4, burime interneti, kaçavidë, metër, gërshërë, gjilpërë, krehër, shkumës, stetoskop etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Vendosen në tavolinën e punës sa më shumë mjete që përdoren për profesione të ndryshme. Nxiten nxënësit që t'i emërtojnë dhe dallojnë sipas profesionit. Cilat nga këto mjete do të doje t'i përdorje kur të rritesh? Pse?




Mekaniku



Rrobaqepësi



Mjekja



Parukieri



Mësuesja



Shkruaj kujt i duhet objekti i paraqitur në figurë për ta kryer punën e tij.










Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vazhdojnë punën me tekst. Emërtojnë profesionet e personave në figura. Gjejnë profesionet sipas mjeteve që përdorin ose sipas asaj që trajtojnë. Në grupe analizojnë veglat dhe materialet që nevojiten për profesionin e caktuar.

Grupi 1: veglat dhe materialet e kuzhinierit.
Grupi 2: veglat dhe materialet e mekanikut.
Grupi 3: veglat dhe materialet e mësueses.
Grupi 4: veglat dhe materialet e mjekes.
Grupi 5: veglat dhe materialet e rrobaqepësit.
Grupi 6: veglat dhe materialet e parukierit.

Plotësohen rubrikat përkatëse në libër.

Hapi 3: Udhëzohen nxënësit që në fletoret e tyre të vizatojnë profesionin që u pëlqen më shumë dhe veglat dhe materialet që u nevojiten. Tregojnë se si mund t'i ndihmojë të tjerët profesioni i zgjedhur.



Plotësojnë tabelën me dy profesione të përzgjedhura.

Profesioni	Veshja/Uniforma	Mjetet e punës	Materialet	Dobia

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet për klasifikimin e veglave të punës sipas profesionit dhe shprehjen e dëshirës për profesionin e parapëlqyer.

Detyrë:

Sjell në shkollë vegla, veshje ose materiale (merr vetëm vegla të përshtatshme për moshën) të profesionit të përzgjedhur.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Profesionet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron me vegla të ndryshme profesione të caktuara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.3, III.2, IV.5, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lojë në grupe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton me të tjerët rreth profesionit të preferuar;
- Demonstron përdorimin e veglave që lidhen me profesionin e preferuar;
- Shpreh ndjenjat dhe mendimet për profesionin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4, burime interneti, kaçavidë, metër, gërrshërë, gjilpërë, krehër, shkumës, stetoskop etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Hapet diskutimi rreth profesionit të preferuar. Nxënësit ndërkohë kanë siguruar edhe disa mjete, materiale ose veshje të profesionit.

Profesione të mundshme të përzgjedhura nga nxënësit mund të jenë: mekaniku, fotografi, rrobaqepësi, mjekja, ushtarja, mësuesja, kitaristja etj.

Hapi 2: Nxiten nxënësit të demonstrojnë përshkrimin e veglave dhe materialet që kanë siguruar.

Profesione të mundshme që do të luajnë fëmijët mund të jenë: kitariste apo violinist që interpreton në instrument; mjeku që vepron me stetoskop; rrobaqepësi që qep një kopsë; ushtarja që parakalon; këngëtari që këndon një këngë; valltarët që vallëzojnë një valle të mësuar; aktorët që luajnë një pjesë të shkurtër skenike; fotografi bën një fotografi të përbashkët me klasën etj.

Profesionet

LOJË NË GRUPE

Diskutoni dhe tregoni se cilat profesione ju pëlqejnë më shumë dhe dëshironi t'i keni në të ardhmen!

Shkruani në fletore për profesionet tuaja më të pëlqyera.



32

LOJË NË GRUPE

Diskutoni dhe tregoni se cilat profesione ju pëlqejnë më shumë dhe dëshironi t'i keni në të ardhmen!

Shkruani në fletore për profesionet tuaja më të pëlqyera.



32

Në këtë mënyrë përfshihen të gjithë nxënësit, individualisht, në dyshe ose grupe të vogla.

Hapi 3: Emocionet, ndjenjat dhe diskutimet nxënësit i paraqesin me shkrim në mënyrë individuale.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet për diskutimin, demonstrimin e profesionit të preferuar dhe shfaqjen e mendimeve për profesionin.

Detyrë:

Plotëson fjalëkryqin në faqen 31, në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për përgjegjësitë që ka në familje lidhur me planifikimin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3, III.2, IV.1, VI.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Si ta organizojmë festën e ditëlindjes?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon përgjegjësi për organizimin e një feste ditëlindjeje;
- Harton një listë me rregulla për mbarrëvajtjen e festës;
- Shkruan një ftesë model për ditëlindje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi, videoprojektor, flipçart, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Hapet diskutimi rreth festës së ditëlindjes. Pyeten nxënësit:

- A i festoni festat e ditëlindjes?
- Me kë bisedoni lidhur me planifikimin e festës?
- Cilat janë përgjegjësitë tuaja kur organizoni festën e ditëlindjes?
- Si i ndani detyrat me anëtarët e tjerë të familjes?

Theksohet se të gjitha organizimet fillimisht duhen diskutuar me të rriturit. Më pas bëhet renditja e punëve për përgatitjen e festës.



Planifikimi dhe shpenzimet

Të bëjmë renditjen e punëve që duhen bërë para festës! Çfarë duhet bërë që të festojmë të lumtur?

1. Shkruajmë listën e shoqeve dhe të shokëve që do të ftojmë.
2. Caktojmë vendin ku do të festojmë.
3. Përgatitim ftesat për të gjithë.
4. Përkujdesemi për stolisjen.
5. Sigurojmë ushqimin për ditën e festës.

Të mbajmë në mend!
Duhet të kemi kujdes si shpenzojmë!
Të gjitha duhet ti llogaritim bashkë me prindërit apo kujdestarët! Ata duhet të pajtohen për to!



58

Hapi 2: Nxiten nxënësit të lexojnë fillimisht tekstin. Më pas plotësohet tabela e përgatitur në flipçart. Nxënësit tregojnë si veprojnë dhe cilat nga këto rregulla i zbatojnë.

Bëjmë listën e të ftuarve:	
Caktojmë vendin e festës:	
Përgatitim ftesat për të gjithë:	
Përkujdesemi për stolisjen:	
Sigurojmë ushqimin:	
Kujdesemi për shpenzimet:	
Kujdesemi për sjelljet gjatë festës:	

Hapi 3: Përpara nxënësve paraqitet një model se si duket një ftesë e ditëlindjes. Më pas kërkohet që edhe ata të shkruajnë ftesën për ditëlindjen e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e përgjegjësi, detyrave dhe detyrimeve gjatë planifikimit të festës dhe mënyra si e kanë shkruar ftesën.

Detyrë:

Me ndihmën e prindërve, i planifikon shpenzimet për festën e ditëlindjes.

Reflektim për rrezdhen e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan mënyrën e planifikimit dhe të vendimmarrjes në shtëpi, në shkollë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nxënësit rregullojnë klasën

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton për mënyrën e kompensimit për dëmin e bërë;
- Paraqet ide dhe sugjerime për mënyrën e kursimit;
- Ndërgjegjësohet për kompensim të dëmit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, burime interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Matematika, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Hapet diskutimi me nxënësit për ndonjë rast të dëmtimit (prishjes) në klasë.

Si ka ndodhur? Kur ka ndodhur? Kush e ka riparuar dëmin e bërë?

Nxënësit këshillohen që hap pas hapi të plotësojnë tabelën e përgatitur paraprakisht. Fillimisht shënojnë çfarë dinë për dëmet dhe çfarë do të donin të dinin.

Di	Dua të di	Mësova
Prishja bëhet pa qëllim.	Si mund të ndihmojnë fëmijët për kompensim të dëmit?	

Planifikimi dhe shpenzimet

NXËNËSIT RREGULLOJNË KLASËN

Derisa po luanin në klasë, nxënësit kishin dëmtuar murin. Ishin shumë të dëshpëruar. Menduan që të organizoheshin bashkërisht dhe të paguanin tetën mjeshtrë që t'ua rregullonte murin. Ata organizuan një takim të përbashkët.



Andi: Propozoj që të mbledhim paratë që kemi marrë për shpenzime ditore.

Andi: Me gjithë dëshirën tonë, kjo nuk mund të ndodhë, sepse prindërit e mi e kanë paguar shumë mjeshtrën, kur po i rregullonte muret e shtëpisë.

60

Dea: E çfarë të bëjmë, pra?

Elsa: Për shpenzime më të mëdha, duhet kursim më i madh.

Rinesa: Propozoj që të huazojmë nga prindërit 100 euro. Çdo ditë të kursejmë nga 10 centë, nga ato që na japin prindërit. Kur të kemi grumbulluar 100 euro, do t'ua kthejmë prindërve.

Te gjithë nxënësit: Jemi të gëzuar! Kemi gjetur zgjidhjen!

KURSEJME

Teta mjeshtre kreu punën!

61

Hapi 2: Luhet lojë me role. Klasifikohen me kujdes mendimet e nxënësve. Në dyshe ata bisedojnë lidhur me planin e fëmijëve. U parashtrohen pyetje të tilla:

- Si ju duken propozimet e nxënësve?
- Si e vlerësoni ju planin e tyre?
- A keni ju ndonjë ide se si mund të kursejnë nxënësit?
- A ju ka ndodhur edhe juve ndonjë rast i ngjashëm?
- A keni ndonjë plan të kursimit në klasë?

Propozoni ndonjë mënyrë të kursimit. Idetë dhe propozimet e nxënësve mbahen shënim.

Hapi 3: Nxiten nxënësit të kujtojnë planifikimin e lartpërmendur dhe shënojnë pikat me radhë.

Di	Dua të di	Mësova
Prishja bëhet pa qëllim.	Si mund të ndihmojnë fëmijët për kompensim të dëmit?	Nevojitet bashkëpunimi. Informimi i prindërve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, idetë e dhëna për kursimin në klasë.

Detyrë:

Bën një plan të kursimit dhe e prezanton atë para klasës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan mënyrën e planifikimit dhe të vendimmarrjes në shtëpi, në shkollë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tregim - Klasa humanitare

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpreh mendimet personale rreth porosisë së tekstit;
- Praktikon kursimin në jetën e përditshme;
- Vlerëson personazhet e tregimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, burime interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Hapet diskutimi lidhur me kursimet e nxënësve dhe për çfarë ata kursejnë zakonisht. Nxënësit tregojnë përvojat dhe shprehin ndjenjat, mendimet dhe gjykimet mbi përdorimin e parave të kursyera. Nxiten ata të tregojnë raste kur paratë e kursyera i kanë përdorur për ndonjë dhuratë, apo për të ndihmuar ndonjë njeri në nevojë.

Hapi 2: Teksti lexohet pjesë-pjesë me ndalesa dhe, pas çdo pjese të lexuar, u drejtohen pyetje.

Pjesa e parë: Çfarë kishin vendosur nxënësit? Si ju duket veprimi i tyre? A keni vepruar edhe ju në këtë mënyrë?

PLANIFIKIMI NË KLASË

Tregim - Klasa humanitare

Nxënësit e klasës së dytë, qysh në fillim të vitit shkollor, kanë vendosur të kursejnë çdo muaj nga një euro në kasën e kursimeve në klasë. Ata po planifikojnë që në muajin maj të vizitojnë një shtëpi të të moshuarve dhe me paratë e kursyera të blejnë diçka që u nevojiten atyre.

Pas disa muajve, ata hapën kasën e kursimeve, së bashku me mësuesen, dhe numëruan 100 euro. Nxënësit u dëshpëruan se kishin mbledhur pak para, ngaqë ata kishin vendosur t'u blinin të moshuarve një freskore, sepse ishte vapë e madhe.

Ata menduan gjatë se çfarë duhej të bënin për të mbledhur më shumë para! Kishin blerë letra me ngjyra të ndryshme dhe punonin broshura, të cilat i këmbenin mes vete me një

Planifikimi dhe shpenzimet

shumë të përshtatshme nga 0.50 centë. Kështu që, nga tregtia e vogël brenda klasës, për afro tri javë të tjera, u tubuan edhe 100 euro dhe ata arritën të blinin freskoren. Përveç kësaj, ata sollën shumë dhurata nga prindërit e tyre për të moshuarit. Më pas, nxënësit, së bashku me mësuesen dhe prindërit, i vizituan dhe i gëzuan të moshuarit.

Pyetje

1. Si t'u duk veprimi i këtyre nxënësve?
2. Si do të kishe vepruar ti?



36

Pjesa e dytë: Çfarë mendoni se kanë bërë nxënësit? Si do të vepronit ju në këtë situatë?

Pjesa e tretë: Si ju duket zgjidhja që gjetën nxënësit?

Pas leximit së tekstit, nxësim kureshtjen e planifikimit edhe te nxënësit: të mendojnë dhe të prezantojnë para klasës se për çfarë do të mund të kursenin edhe ata.

Hapi 3: Përsëritet planifikimi i lartshënuar dhe nxënësit plotësojnë ngjarjen në fletën e përgatitur duke shprehur mendimet dhe qëndrimet për personazhet e tregimit.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrje në diskutim, shprehje të qëndrimit dhe vlerësimin për personazhet e tregimit.

Detyrë:

Diskuton me prindërit, planifikon një aktivitet humanitar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për përgjegjësitë që ka në familje lidhur me planifikimin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Çfarë duhet ditur për kursimet në familje?

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon përgjegjësitë gjatë një planifikimi në familje;
- Respekton detyrat dhe përgjegjësitë për kursime;
- Shpreh dëshirat për kursime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, flipçart, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Paraqiten përmes videoprojektorit ose në flipçart fjalët kyçe: ushqim, veshmbathje, mjete shkollore, lodra etj.

Pyeten nxënësit: Si mund t'i sigurojmë këto të mira materiale? A kemi mundësi t'i sigurojmë gjithmonë këto?

Hapet diskutimi dhe arrihet në përfundimin se për t'i siguruar të gjitha këto të mira materiale duhet të bëjmë një plan kursimi.

Hapi 2: Lexohen situatat e paraqitura në tekst, ku përshkruhet mënyra e kursimit. Diskutohet veçmas për secilën nga to:

Planifikimi dhe shpenzimet



TË BISEDOKJME

- Si e vlerësoni planin e nxënësve?
- Çfarë mendoni për kursimet që bënë?
- A keni ndonjë plan të përbashkët kursimi në klasë?

ÇFARË DUHET DITUR PËR KURSIMET NË FAMILJE?

Në çdo familje kursehet. Prindërit kanë kursyer para për të blerë banesën ose shtëpinë, veturën, mobilet, biçikletën etj.

E pra, si mund të ndihmojmë edhe ne për të kursyer para?

- Mund të ushqehemi në shtëpi, sepse na kushton më pak dhe është më mirë për shëndetin tonë.
- Sa herë që dalim nga shtëpia, të fikim televizorin dhe dritat.
- Ta shpenzojmë ujin me kujdes.
- T'i qepim robat që na janë grisur.

ÇFARË TË PËLQEN TË BLESHE DHE PËRSE DO TË KURSEJE PARA?

Do të kurseja për:	Si do të kursesh?
1. biçiklete	- Do të vizitoj me rrallë lojërat me pagesa duke shfrytëzuar hapësirat e qytetit (parkun e qytetit). - Do të blej me pak lodra.
2.	
3.	

Të mbajmë në mend!
Prinderit tanë punojnë shumë për të fituar para!
Ato duhen harxhuar me shumë kujdes!
Dëshirat tona nganjehere mund të jenë shumë të kushtueshme!



63

- Ushqimin e pushimit të shkollës e marrim në shtëpi, është më lirë dhe më i shëndetshëm.
- I fikim dritat dhe pajisjet e tjera që shpenzojnë energjinë elektrike kur nuk jemi duke i përdorur.
- Nuk e shpërdorojmë ujin në asnjë rast dhe në asnjë mënyrë.
- Nuk kërkojmë të blejmë gjëra të shtrenjta për të cilat nuk kemi nevojë.

Nxënësit dallojnë nevojat dhe dëshirat.

Hapi 3: Si duhet të veprojmë në mënyrë që të kursejmë? Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe në fund e gjithë klasa nxjerr disa përfundime.

1. Hartohet një plan kursimi.
2. Shkruhen idetë që ndihmojnë këtë plan.

Do të kurseja për:	Si do të kurseni?
1. Biçiklete	- Do të vizitoj me rrallë lojërat me pagesa duke shfrytëzuar hapësirat e qytetit (parkun e qytetit). - Do të blej me pak lodra.
2.	
3.	

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për diskutimet lidhur me planifikimin, përgjegjësitë dhe dëshirat për kursimin në përgjithësi.

Detyrë:

Në fletore pune (faqe 37) shkruan për dëshirat që ka dhe nëse kursen për to.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan mënyrën e planifikimit dhe të vendimmarrjes në shtëpi, në shkollë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, II.5, III.2, IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Planifikimi i kursimit në familje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Planifikon aktivitetet të kursimit në familje;
- Shpjegon që kursimi i tyre ndihmon në familje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, burime interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me fjalë të ndara (Gjyshi, i Anës, dhe, ka, i Anit, ditëlindjen) dhe kërkohet nga ata që në grupe të formojnë fjalinë (Gjyshi i Anit dhe i Anës ka ditëlindjen.)

Pasi të kenë formuar fjalinë, disa nga nxënësit e lexojnë atë.

Po gjyshi juaj, kur e ka ditëlindjen? A mendoni t'i blini ndonjë dhuratë? Si mendoni t'i kurseni paratë për t'ia blerë dhuratën?

A keni ndonjë plan për kursim?

Hapi 2: Lexohet teksti dhe diskutohet me nxënësit. Analizohet planifikimi i Anit dhe i Anës.

Çfarë mendoni, a do të arrijnë të kursenë mjaftueshëm për dhuratën? Po ju, a keni kursyer ndonjëherë? Pse keni kursyer?

Nxiten nxënësit që në mënyrë individuale t'i plotësojnë mendimet e tyre lidhur me planifikimet, kursimet dhe mënyrën se si kanë kursyer.

Planifikimi dhe shpenzimet

PLANIFIKIMI I KURSIMIT NË FAMILJE

Gjysha e Anit dhe e Anës ka ditëlindjen pas 3 muajsh. Ata kishin menduar gjatë që t'ia bënin një dhuratë. Derisa erdhi koha e ditëlindjes së gjyshes, ata kursyen një shumë parash.



Pyetje	Përgjigje
A mendoni t'u bëni befasi prindërve dhe gjyshërve?	
A keni kursyer ndonjëherë? Në qoftë se po, për çfarë?	
Shpjegoni mënyrën e të kursyerit.	

Planifikimi dhe shpenzimet

PLANIFIKIMI I KURSIMIT NË FAMILJE

Gjyshja e Anit dhe e Anës ka ditëlindjen pas 3 muajsh. Ata kishin menduar gjatë që t'ia bënin një dhuratë. Derisa erdhi koha e ditëlindjes së gjyshes, ata kursyen një shumë parash.



Pyetje	Përgjigje
A mendoni t'u bëni befasi prindërve dhe gjyshëve?	
A keni kursyer ndonjëherë? Në qoftë se po, për çfarë?	
Shpjegoni mënyrën e të kursyerit.	

38

Pyetje	Përgjigje
A mendoni t'u bëni befasi prindërve dhe gjyshëve?	
A keni kursyer ndonjëherë? Në qoftë se po, për çfarë?	
Shpjegoni mënyrën e të kursyerit.	

Hapi 3: Në fund, nxënësit bëjnë një planifikim për një rast të veçantë:

Sa kohë do t'u duhet të kursejnë? Çfarë dhurate do të blejnë? A do të bëjnë një plan të përbashkët me vëllanë ose motrën?



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin, bashkëpunimin në planifikim dhe shpjegojnë kursimin.

Detyrë:

Planifikon si do të kursejë për një dhuratë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Planifikimi

Rezultatet e të nxënit të temës:

Diskuton për të ardhurat dhe shpenzimet bashkë me familjen.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Planifikimi familjar - Lojë skenike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpreh nevojat dhe dëshirat;
- Dallon të ardhurat dhe shpenzimet në familje;
- Identifikon përgjegjësitë e veta për kursimin në familje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, flipçart, fotografi, ilustrime, burime interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit të tregojnë cilat janë nevojat dhe dëshirat e tyre. Plotësohet në bashkëpunim me tërë klasën në tabelën e parapërgatitur.

Dëshirat	Nevojat

PLANIFIKIMI FAMILJAR



Lojë skenike

Lira: Shoqja ime ka një telefon, ndërsa unë nuk kam. Dëshiroj që edhe unë të kem një të tillë.

Liri: Nëse ti do telefon, atëherë dhe unë dua videolojë time të preferuar.


Nëna: Si thoni të bisedojmë e gjithë familja së bashku për ekonominë dhe buxhetin familjar, e të vendosim për dëshirat tuaja?

Babai dhe nëna: Fëmijët e mi, me gjithë dëshirë do të donim t'ju plotësonim kërkesat tuaja, por tani që ne sapo kemi blerë shtëpi të re, kemi shpenzuar shumë dhe kemi fatura për të paguar. Këto janë nevojat më të rëndësishme dhe, tani, nëse behen shpenzime të tjera, ne nuk do t'ia dalim me buxhetin familjar. Por, ju premtojmë se shumë shpejt do t'ju plotësojmë dëshirat.

Lira dhe Liri: O sa jemi të gezuar që prindërit se shpejt do të na gëzojnë duke na i plotësuar dëshirat tona!

Planifikimi dhe shpenzimet

Plotëso fjalëkryqin, duke u bazuar në figurat e dhëna.



- 1) Planifikimi
- 2) Dyqani
- 3) Biznesi
- 4) Ekonomi
- 5) Fabrika
- 6) Tregtia
- 7) Kursimi

40

Hapi 2: Lexohet teksti në role dhe më pas diskutohet dhe analizohet ai. Kërkohet nga nxënësit të luajnë rolet e personazheve në tekst, se si do të vepronin ata sikur të ishin në vendin e tyre. Tregojnë nëse u ka ndodhur edhe atyre ngjashëm dhe si kanë reaguar në këto situata. Arsyetojnë realizimin e dëshirave sipas mundësive.

A keni edhe ju ndonjë dëshirë? A mund t'i realizoni gjithmonë dëshirat? Pse?

Arrihet në përfundim që shpesh nuk mund të realizohen të gjitha dëshirat dhe se të gjithë duhet të kursejnë, me qëllim që shpenzimet të mos jenë më të mëdha se të ardhurat.

Hapi 3: Analizohen personazhet e tekstit. Nxënësit, në dyshe, shënojnë se çfarë mendojnë për secilin nga ta dhe si do të vepronin sikur të ishin në vendin e tyre.

Nëna	Babai	Lira	Liri

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shprehjen e dëshirave dhe të nevojave, dallimin midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe identifikojnë përgjegjësitë për kursim në familje.

Detyrë:

Plotëson faqen 40, fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Njih dhe zbaton në vazhdimësi e në mënyrë të vetëdijshme rregullat e higjienës, duke u kushtuar kujdes vetes, mjedisit në shkollë dhe në shtëpi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.6, V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Zbatimi i rregullave të higjienës dhe kujdesi për vete

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Rendit rregullat e higjienës personale dhe të mjedisit;
- Praktikon rregullat e higjienës personale dhe të mjedisit ku jeton.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, burime interneti, sapun.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u paraqiten dy fotografi: njëra me ambient të pastër dhe tjetra me mjedis të papastër.

Kërkohet prej tyre që të kujtojnë sa më shumë shembuj të zbatimit të higjienës dhe të kujdesit ndaj vetes. Pyeten: A i pastroni duart para se të vini në mësim? Cilat veprime të tjera ndërmerrni? Po si kujdeseni për mjedisin jetësor në shtëpi dhe shkollë?

Hapi 2: Rregulli themelor i higjienës është pastrimi i duarve në mënyrën e duhur. Pasi të jetë demonstruar para nxënësve mënyra e drejtë e larjes së duarve, ky veprim praktikohet edhe nga ata. U tërhiqet vërejtja që duart duhet të lahen me ujë të ngrohtë dhe me sapun.

Mjedisi dhe shëndeti

5.

MJEDISI DHE SHËNDETI

- Zbatimi i rregullave të higjienës dhe kujdesi për veten
- Rregulla të tjera për mbajtjen e higjienës personale, të mjedisit në shtëpi dhe në shkollë
- Mënyra e veprimit në rastin e shfaqjes së ndonjë sëmundjeje
- Veprimet që kryhen për mbajtjen e pastërtisë
- Shkaktarët e ndotjes së ambientit



ZBATIMI I RREGULLAVE TË HIGJENËS DHE KUJDESI PËR VETEN

Rregulla themelore e higjienës është mbajtja e duarve pastër.

Ja disa nga rastet kur duhet t'i pastroni duart:



Kur ktheheni në shtëpi.



Para dhe pas ngrënies së ushqimit.



Pasi të shkoni në banjë.



Pas teshtitjes ose kollitjes.




Pas lojës me kafshë.



Pas lojës jashtë.

Hapi 3: Pasi të jetë shënuar në tabelë shprehja “Duart i pastrojmë në këto raste”, grafiku plotësohet me mendimet e nxënësve.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për renditjen e rregullave, praktikat e tyre dhe bashkëpunimin.

Detyrë:

Praktikon larjen e duarve në mënyrë të rregullt,
para dhe pasi të hajë ushqim.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Njih dhe zbaton në vazhdimësi rregullat e higjienës, duke u kushtuar kujdes vetes, të tjerëve, mjedisit në shkollë dhe në shtëpi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.6, V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Rregulla të tjera për mbajtjen e higjienës personale, të mjedisit në shtëpi dhe shkollë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rregulla për mirëmbajtje të higjienës;
- Zbaton rregullat e higjienës personale dhe të mjedisit;
- Shpjegon përfitimet nga higjiena.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Diskutohet fjala “higjienë”. Nxënësit nxiten të dallojnë higjienën personale dhe të mjedisit në shtëpi, shkollë apo në mjedise të tjera. Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Higjiena personale

Higjiena e mjedisit shtëpiak

Higjiena e mjedisit shkollor



Mjedisi dhe shëndeti

RREGULLA TË TJERA PËR MBAJTJEN E HIGJENËS PERSONALE, TË MJEDISIT NË SHËTËPI DHE NË SHKOLLË



Higjena e gojës



Higjena e trupit



Higjena e flokëve



Higjena e tualetit



Higjena e duarve



Higjena e shtëpisë




Mjetet higjienike



Mbajtja pastër e ambientit ku më.

66

Hapi 2:



Fillimisht hapet diskutimi rreth ilustrimit në tekst. Si ju duket veprimi i fëmijëve? A keni vepruar edhe ju ndonjëherë ngjashëm në mjedisin tuaj jetësor? Cilat rregulla të higjienës i zbaton?

Nxënësit fokusohen në ilustrimet e tekstit. Në veçanti, diskutohet për higjienën e duarve, të gojës, të flokëve, të trupit, të tualetit, të shtëpisë në përgjithësi. Ata nxiten të sjellin sa më shumë shembuj nga jeta e tyre.

Hapi 3: Për mbajtjen e higjienës personale dhe të mjedisit jetësor, përveç ujit, njerëzit përdorin edhe detergjentë të ndryshëm.

Kërkohet nga nxënësit të vizatojnë mjetet e higjienës që përdorin në shtëpi ose shkollë.



Disa nga këto mjete kanë përmbajtje të rrezikshme. Këshillohen që pa mbikëqyrjen e të rriturve të mos i përdorin.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen, përshkrimin, zbatimin dhe shpjegimin e rregullave të mbajtjes së higjienës personale dhe të mjedisit jetësor.

Detyrë:

Pastron dhomën e vet dhe i përshkruan ndryshimet.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Njeh dhe zbaton në vazhdimësi rregullat e higjienës, duke u kushtuar kujdes vetes, të tjerëve, mjedisit në shkollë dhe në shtëpi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.6, V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rregulla për mirëmbajtje të higjienës personale;
- Emërton produktet dhe mjetet e higjienës personale;
- Shkruan rreziqet nga mosmbajtja e higjienës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, flipçart, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1:

Trego sa herë në ditë dhe kur i lan dhëmbët.

Trego pas cilave veprime i pastron duart.

Kërkohet nga nxënësit të mendojnë për kërkesat e paraqitura dhe mendimet e tyre t'i diskutojnë në grup. Pasi t'i kenë shkëmbyer mendimet, secili nxënës shënon në flipçart nga një mendim. Kështu vazhdojnë edhe nxënësit e tjerë.

HIGJIENA PERSONALE

Trego sa herë në ditë dhe kur i pastron dhëmbët.



Blank lines for writing answers.

Trego se pas/para cilave veprime i pastron duart.

Blank lines for writing answers.



MJETET E HIGJENËS PERSONALE



Shkruaj emrat e produkteve dhe të mjeteve që nevojiten për higjienën personale dhe trego se për çfarë i përdor.

Pasta e dhëmbëve	Për pastrimin e dhëmbëve

44

Diskutohen mendimet e tyre. Nxiten të tregojnë se cili nga mendimet u pëlqen më shumë dhe përshtatet më tepër me veprimet e tyre.

Hapi 2: Kërkohet nga nxënësit që individualisht ta plotësojnë ushtrimin në tekstin e tyre. Shkruajnë emrat e produkteve dhe të mjeteve që duhen për higjienën personale. Tregojnë për çfarë i përdorin ato.

Pasta e dhëmbëve	Për larjen e dhëmbëve

Hapi 3: Nxënësit nxiten të reflektojnë rreth fjalës “Pastërtia është gjysma e shëndetit”. Mendimet e tyre i diskutojnë në dyshe. Më pas, ato i paraqesin edhe para klasës.

Nëse nuk i laj duart para dhe pas ushqimit:	
Nëse nuk i laj dhëmbët me rregull:	
Nëse i hedh mbeturinat kudo:	
Nëse nuk i pastroj dhe kreh me rregull flokët:	
Nëse nuk i laj frutat para se t'i ha:	

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin e produkteve për mbajtje të higjienës dhe për shmangien e rreziqeve nga mosmbajtja e higjienës.

Detyrë:

Përpilon një listë të produkteve të nevojshme për pastrimin e klasës. Tregon se për çfarë përdoren ato.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan mënyrën e veprimit me rastin e paraqitjes së ndonjë sëmundjeje.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.6, V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Mënyra e veprimit me rastin e paraqitjes së ndonjë sëmundjeje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton shkaktarët që e nxisin sëmundjen;
- Përshkruan mënyrën e veprimit kur është sëmurë;
- Rendit veprimet për shmangie të sëmundjeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, fotografi, videoprojektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Paraqitet pyetja për diskutim: Cilët janë shkaktarët e sëmundjeve?

Nxënësit fillimisht diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Mendimet e tyre shënohen në tabelë.

Përgjigje të mundshme nga nxënësit mund të jenë: *të ftohtët, nga papastërtia, gjumi i pamjaftueshëm, qëndrojnë gjatë para kompjuterit dhe nuk dal në natyrë, ha ushqime të pashëndetshme* etj. Vazhdohet diskutimi duke pyetur:

- Si duhet të veprohët me rastin e paraqitjes së ndonjë sëmundjeje?
- Kur nuk ndiheni mirë, kujt duhet t'i drejtoheni?



SËMUNDJET DHE SHKAKTARËT E TYRE

Llojet e sëmundjeve	Shkaktarët
	Imuniteti i dobët shkaktohet nga...
	
	
	
	



46

Hapi 2: Llojet e sëmundjeve mund të jenë të ndryshme. Në tekstin e nxënësve janë evidentuar disa nga to. Nxënësit shkruajnë shkaktarët e këtyre sëmundjeve.

Llojet e sëmundjeve	Shkaktarët
	Imuniteti i dobët shkaktohet nga ...
	
	
	
	

Nxiten nxënësit të tregojnë se si kanë vepruar në rast të paraqitjes së këtyre sëmundjeve. Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

Hapi 3: Sëmundjet paraqiten si pasojë e veprimeve të gabuara. Disa nga to i evidentojnë nxënësit dhe tregojnë cilat veprime ndërmarrin për të shmangur sëmundjet.

Sëmundja	Shkaku	Veprimi për shmangie të sëmundjes
Më dhemb dhëmbi	Ha shumë ëmbëlsira	Do të ha më shumë fruta

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin e shkaktarëve të sëmundjeve, bashkëpunimin, mënyrën e veprimit për shmangien e sëmundjeve.

Detyrë:

Shënon sëmundjet më të shpeshta të fëmijëve dhe shkaktarët që ndikojnë në paraqitjen e tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan veprimet që kryhen për mbrojtjen e pastërtisë individuale, ambientit, klasës, shkollës dhe mjedisit përreth.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.6, V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Veprimet që kryhen për mbajtjen e pastërtisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan veprimet që duhen bërë për higjienën personale;
- Zbaton rregullat e higjienës së mjedisit jetësor;
- Praktikon rregullat e higjienës personale.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Për të mbajtur pastërtinë në shtëpi, klasë, në shkollë dhe mjedisin përreth, duhet vepruar kështu:



Nxiten nxënësit të shprehin sa më shumë mendime. Ato shënohen te pema e mendimeve, e përgatitur paraprakisht.

Mjedisi dhe shëndeti VEPRIMET QË KRYHEN PËR MBAJTJEN E PASTËRTISË

Duhet të kujdeseni për ambientin tuaj në shtëpi, në shkollë, si dhe gjithkund tjetër ku rini a luani.



Pastroni kembët para se të hyni në shkollë.



Hidhni plehrat në shportat e plehrave.



Ndihmoni prindërit në pastrimin dhe rregullimin e shtëpisë.



Mbajeni pastër klasën.

Mjedisi dhe shëndeti



Pastroni mjedisin në shkollë dhe në shtëpi.

Duhet të kujdeseni që ambienti juaj në të cilin keni punuar të pastrohet pasi të keni përfunduar detyrën/aktivitetin e caktuar.

KLASIFIKIMI I MBETURINAVE SIPAS LLOJIT DHE MATERIALIT

Riciklimi është ripërpunimi i materialeve të ngurta të hedhura, në produkte të reja të dobishme.



Kjo shenjë tregon që materiali mund të riciklohet, pra të përdoret serish.

69

Hapi 2: Nxiten nxënësit të tregojnë se cilat veprime i ndërmarrin për mirëmbajtjen e mjedisit të tyre jetësor në shtëpi ose shkollë.

Si veprojmë me mbeturinat?

Kur prindërit pastrojnë shtëpinë, çfarë bëjnë?

Kur pastrojmë klasën, si ndihmojmë unë?

Hapi 3: Analizohet rubrika e fundit “Kur pastrojmë klasën, si ndihmojmë unë”?

Kërkohet që së bashku të ndërmerret një aktivitet praktik për pastrim të bankave dhe karriqeve. Shpërndahen lecka për nxënësit dhe secili e pastron hapësirën e vet punuese.

Në përfundim të punës, të gjithë praktikojnë rregullat e mësuara për larjen e duarve. Procesi mbikëqyret dhe këshillohet nxënësit sipas nevojës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për angazhimin në aktivitetin praktik, zbatimin dhe praktikimin e rregullave të higjienës së mjedisit dhe atë personale.

Detyrë:

Pastron dhomën e vet dhe tavolinën e punës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan veprimet që kryhen për mbrojtjen e pastërtisë së ambientit dhe të mjedisit përreth.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, I.3, III.2, IV.6, V.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Pastërtia e mjedisit që ju rrethon

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon pastërtinë e mjedisit ku jeton;
- Përshkruan mjedisin në bazë të fotografive;
- Paraqet mjedisin e tij jetësor përmes vizatimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësit analizojnë tri situatat e paraqitura në tekstin e tyre.



Cila nga këto tri mjedise ju pëlqen më shumë? Pse? Si veprojnë ata për të pasur një mjedis të këndshëm?

Mjedisi dhe shëndeti PASTËRTIA E MJEDISIT QË JU RRETHON

Diskuto dhe shkruaj rreth pastërtisë së dhomës, klasës dhe mjedisit në fotografitë e dhëna:



PASTËRTIA E MJEDISIT QË JU RRETHON

Diskuto dhe shkruaj rreth pastërtisë së dhomës, klasës dhe mjedisit në fotografitë e dhëna:



45

Hapi 2: Nxënësit diskutojnë në grupe rreth pastërtisë së dhomës, klasës dhe mjedisit të jashtëm të paraqitura në fotografi. Udhëzohen të përshkruajnë mjedisin përkatës duke u bazuar në këto fotografi.

Grupi i parë përshkruan fotografinë e parë.

Grupi i dytë përshkruan fotografinë e dytë.

Grupi i tretë përshkruan fotografinë e tretë.

Hapi 3: Në pjesën e fundit nxënësit paraqesin mjedisin e tyre jetësor përmes vizatimit. Vizatimet ekspozohen te këndi i artit. Nxënësit janë të lirë të lëvizin, të analizojnë dhe t'i krahasojnë vizatimet e tyre me ato të shokut a shoqes.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për përshkrimin dhe paraqitjen me vizatim të mjedisit jetësor.

Detyrë:

Krijon një model rreth shprehjes “Mjedisi dhe shëndeti”.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron klasifikimin e mbeturinave sipas llojit të materialit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, IV.6, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Klasifikimi i mbeturinave sipas llojit dhe materialit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon, klasifikon mbeturinat sipas llojit të materialit;
- Mëson se riciklimi është ripërpunim i materialeve të ngurta, të hedhura, në produkte të reja të dobishme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, pako ambalazhi, shishe plastike, xham etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Hapet diskutimi rreth pyetjes: Ku mendoni se përfundojnë gjithë mbeturinat?

Nxënësit lihen që të mendojnë, të shkëmbejnë mendimet e tyre në dyshe dhe në grupe. Më pas, ato i paraqesin para klasës.

Shfaqen përmes videoprojektorit shportat me ngjyra dhe pyeten se a e dinë çfarë domethënie ka secila nga to.

Më pas shkruhet në tabelë fjala *riciklimi* dhe kërkohet të tregojnë çka dinë për të.

Hapi 2: Vazhdon puna me tekst. Nxënësit i dallojnë materialet se cilat mund të riciklohen dhe cilat jo.

Analizohet fotografia e shportave me ngjyra dhe klasifikimi i materialeve.

Mjedisi dhe shëndeti

Materialet që riciklohen janë treguar në vijim:



LETRA



QELQI



KANAÇET E ALUMINIT

70

Mjedisi dhe shëndeti



METALET



**DISA LLOJE
TË PLASTIKËS**



**BIMËT DHE
USHQIMET**

Në rastin e hedhjes së mbeturinave në shportë, duhet të ndahen materialet që riciklohen. Pastaj, mbeturinat me materiale të caktuara mblidhen dhe dërgohen në fabrika për riperpunim.

71



Hapi 3: Paraprakisht janë sjellë në klasë materiale të ndryshme të riciklueshme: shishe uji, xham, lugë plastike, letra ambalazhi, pako të produkteve të ndryshme, kanaçe alumini, lugë metali etj.

Në të dyja skajet e klasës janë vendosur nga katër pako, në të cilat shkruan: letër, plastikë, metal dhe xham.

Nxënësit garojnë në dyshe, qëndrojnë në mes të klasës dhe në momentin kur dëgjojnë sinjalin fillojnë lojën. Ata kanë të drejtë të marrin vetëm një objekt. Loja vazhdon derisa të gjitha objektet të vendosen në pakot përkatëse. Fiton ai që ka grumbulluar më shumë objekte dhe i ka vendosur në pakon e duhur. Loja vazhdon edhe me nxënësit e tjerë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për klasifikimin e mbeturinave sipas llojit dhe shpjegon për riciklimin.

Detyrë:

Plotëson faqen 47 në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Emërton shkaktarët e ndotjes së ambientit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, IV.6, V.1, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.1, 9.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Shkaktarët e ndotjes së ambientit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Njeh shkaktarët e ndotjes së ambientit;
- Dallon ndotësit kryesorë në ambientin tonë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutohet rreth situatave të paraqitura në tekstin e nxënësit. Parashtrohen pyetje të tilla:

Si ju duken veprimet?

Cilat janë pasojat e këtyre veprimeve?

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.

Hapi 2: Nxënësit shkruajnë në fletore për shkaktarët dhe pasojat e ndotjes.



SHKAKTARËT E NDOTJES SË AMBIENTIT

Mjedisi dhe shëndeti

Ndotësit shtesë të ambientit janë substanca të papastrat që e ndotin ajrin, ujin dhe tokën tonë.



Shembuj të ndotjes së ajrit nga industria dhe automobilat



Shembuj të ndotjes së Tokës

73

Mjedisit dhe shëndeti



Hapi 3: Për mbrojtjen e mjedisit nga ndotësit kryesorë, duhet të ndërmerren disa veprime. Nxiten nxënësit të arsyetojnë me shembuj konkretë.

Ngasim biçikletën, sepse: _____

Hedhim mbeturinat në vendin e caktuar, sepse: _____

Ndajmë mbeturinat sipas llojit, sepse: _____

Në shkollë vijmë në këmbë, sepse: _____

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për njohjen e shkaktarëve të ndotjes dhe dallimin e tyre.

Detyrë:

Vizaton tre ndotësit kryesorë të mjedisit jetësor.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II

Tema: Mjedisi dhe shëndeti

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, IV.6, V.1, V.3, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Frutat dhe perimet

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton frutat dhe perimet që konsumon më shpesh;
- Tregon rëndësinë e konsumimit të frutave dhe të perimeve për shëndetin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit dëgjojnë këngën “Sa i dua frutat”, në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=8f-hdCoqI-tI>, dhe “Unë perimet shumë i dua”.

Pasi t’i kenë dëgjuar këngët, pyeten:

- Po ju, a i doni frutat dhe perimet? Pse?
- Cilat fruta më shumë i preferoni?


Hapi 2: Udhëzohen nxënësit ta plotësojnë fjalëkryqin në tekstin e tyre, horizontalisht dhe vertikalisht, sipas figurave të dhëna.

Tregojnë për ushqimet e tyre të preferuara të përgatitura me fruta dhe perime. Shpjegojnë pse është e dobishme të konsumohen çdo ditë fruta dhe perime.

Mjedisi dhe shëndeti

FRUTAT DHE PERIMET

Plotëso fjalëkryqin, duke u bazuar në figurat e dhëna.




- 1) Molla
- 2) Dardha
- 3) Karota
- 4) Tranguj
- 5) Domate
- 6) Shalqiri
- 7) Rrushi

48

Mjedisi dhe shëndeti

FRUTAT DHE PERIMET

Plotëso fjalëkryqin duke u bazuar në figurat e dhëna.



- 1) Molla
- 2) Dardha
- 3) Karota
- 4) Tranguj
- 5) Domate
- 6) Shalqiri
- 7) Rrushi

48

Hapi 3: Vizatojnë frutat dhe perimet nga fjalëkryqi.

Vizatimet e përfunduara ekspozohen në këndin e artit. Nxënësit lëvizin të lirë, diskutojnë lidhur me punimet e shokëve/shoqeve të klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin e frutave dhe perimeve, rëndësinë e tyre për shëndetin, pjesëmarrjen në diskutim dhe plotësimin e fjalëkryqit.

Detyrë:

Përgatit një sallatë nga frutat ose perimet për shujtën e pushimit në shkollë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon disa lloje mediesh dhe liston emisionet e TV-së në bazë të moshës përkatëse.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.3, III.3, VI.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mediet dhe llojet e tyre

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton disa lloje të medieve, të shkruara dhe elektronike;
- Dallon llojet e medieve sipas kohës së zbulimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, letra formati A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të shikojnë dhe të analizojnë faqet përkatëse në tekstin e tyre.

Pyeten:

- Çfarë po shihni?
- Përgjigje të mundshme mund të jenë: televizor, radio, gazeta, kompjuter etj.
- A e dini se për çfarë shërbejnë? Cilat prej tyre i përdor më shumë? Pse?

Hapi 2: Lexohet teksti dhe pyeten nxënësit:

- Si informoheshin njerëzit në kohët e lashta?
- Cilat ishin mjetet më të shpeshta të informimit?
- Po sot, cilat mjete të informimit përdorin më shumë njerëzit?

Kërkohet nga nxënësit që në tekstin e tyre të shënojnë emrat e të gjitha mjeteve të informimit të për-

MEDIET DHE LLOJET E TYRE

Mjetet e informimit janë: gazeta, revista, radioja, televizori, telefoni, kompjuteri dhe interneti. Më parë, njerëzit informoheshin në mënyra të ndryshme. Së pari kanë filluar me anë të letrës që dërgohej në mënyrë postare. Pastaj u zbuluan radioja, televizori, telefoni, kompjuteri dhe interneti.

Të njihemi me mjetet e informimit!



Mediet


Shkruaj emrat e mjeteve të informimit të dhëna në figura.



mendura dhe të paraqitura.

Ato dallohen sipas kohës së zbulimit.

Hapi 3: Shënohet në tabelë ose flipçart “Llojet e informimit” dhe kërkohet që të rikujtohen të gjitha mjetet e mësuara. Shënohen mendimet e nxënësve në organizuesin grafik. Edhe nxënësit shënojnë në fletët A4, të përgatitura paraprakisht.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin e mediave, dallimin e tyre, angazhimin dhe bashkëpunimin.

Detyrë:

Pyet prindërit se cilin nga llojet e medieve përdorin më tepër. Tregon pse.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon disa lloje mediesh dhe liston emisionet e TV-së në bazë të moshës përkatëse.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.3, III.3, VI.4, VI.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Mjetet e informimit dhe programet e parapëlqyera

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton disa lloje të programeve televizive;
- Dallon programet televizive sipas përmbajtjes;
- Përshkruan programin televiziv të parapëlqyer.

Kriteret e suksesit:

Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS


Hapi 1: Me ndihmën e videoprojektorit ose përmes fotografive, paraqiten mjete të ndryshme informimi që përdorin njerëzit. Nxiten nxënësit të tregojnë sa nga to njohin dhe cilat i përdorin më shumë. Përgjigje të mundshme të nxënësve: televizori, radioja, telefoni, interneti, gazeta, revista, libri, letra etj. Shpjegohet se disa nga këto mjete janë përdorur më shumë në të kaluarën, ndërsa sot përdoren të tjera. Nxënësit i radhisin ato sipas kohës së zbulimit.

Hapi 2: Shpjegohet që programet e ndryshme që shikojnë dallojnë sipas përmbajtjes. Nxiten nxënësit t'i dallojnë këto programe. Evidentohen edhe në tabelë përgjigjet e tyre. Në mënyrë individuale, ata plotësojnë faqen përkatëse në tekstin e tyre.

Mediet
Lidh me shigjetë figurat e paraqitura më poshtë:



53



Mediet

Shkruaj programet televizive më të pëlqyera për ty!

Lista e programeve televizive	Emri i programeve të pëlqyera
Informative	
Sportive	
Argëtuese	
Muzikore	



54

Lista e programeve televizive	Emri i programeve të preferuara
Informative	
Sportive	
Argëtuese	
Muzikore	

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë programin televiziv të parapëlqyer. Diskutohet për këto programe.

- A është edukativ?
- Çka mësojmë nga ai?
- A është program argëtues?
- Me kë e përcjellin programin?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për emërtimin e programeve televizive, dallimin e tyre sipas përmbajtjes dhe përshkrimin e programit të parapëlqyer.

Detyrë:

Shkruan në kompjuter një lajm që ka dëgjuar në radio ose televizor.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Luan rolin e moderatorit gjatë aktiviteteve brenda klasës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.3, I.6, VI.2, VI.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lojë skenike - Rinori dhe Alba

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson veprimet e personazheve;
- Shpreh mendimet personale rreth porosisë së tekstit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Hapet diskutimi lidhur me përdorimin e televizorit, të gazetës, të internetit, të telefonit, të kompjuterit dhe të mjeteve të tjera të informimit. Nxënësit tregojnë përvojat dhe shprehin ndjenjat, mendimet dhe gjykimet mbi përdorimin e tyre. Tregojnë se a kanë një orar të caktuar për përdorimin e këtyre pajisjeve dhe a mbikëqyren nga të rriturit.

Pyeten nxënësit:

- Sa zgjat filmi, përralla ose loja që shikon në kompjuter ose telefon?

Hapi 2: Teksti lexohet në role me ndalesa dhe, pas çdo pjese të lexuar, drejtohen pyetje.

Pjesa e parë: Çfarë mendimi keni për Albën? Si ju duket veprimi i saj? A kishte ajo të drejtë?

Pjesa e dytë: Si mendoni, a kishte të drejtë Rinori që e qortoi Albën? Si do të vepronit ju? Si do ta këshillonit motrën a vëllanë?

LOJË SKENIKE - MEDIET

Mediet

Rinori dhe Alba

Alba, pasi kreu mësimet dhe detyrat, po luante një lojë në kompjuter. Ajo po kënaqej, por lojës ia kishte lëshuar zërin shumë dhe po e pengonte vëllanë që ishte duke lexuar një lektyrë. Ata filluan të ziheshin me njëri-tjetrin.

Rinori - E sheh që më pengon me tërë atë zë?

Alba - Po vëlla, ti vetëm lexon libër e nuk je duke mësuar, çfarë të keqe ka që luaj? Unë i kreuva mësimet e tani jam duke u relaksuar.

Rinori - Si ç'të keqe ka? Ti luan tashmë që 1 orë dhe rrezatohesh me rreze të dëmshme për shëndetin tënd.

(Duke dëgjuar këtë bisedë, libri, radioja, televizori dhe kompjuteri vendosin të përfshihen.)

Kompjuteri - Rinor, ore Rinor, ç'të keqe kanë lojërat e mia?

Radioja - Si ç'të keqe? Ua shkatërrove sytë fëmijëve. Më mirë të degjojnë muzikë dhe të kënaqen me mua.

Televizori - Muzikë?! Pse të mos argëtohen me filmat e animuar që ua dhuroj?

Libri - Ha-ha-ha! Pse po grindeni kot? Po mos të isha unë me informacione dhe mësim, ju nuk do të zbuloheshit fare. Andaj, fëmijë, lexoni sa më shumë libra, se truri juaj i njomë ka fuqi që të zbulojë gjëra edhe më të mrekullueshme se kompjuteri.

Kompjuteri - Oh, i mjeri unë i mjeri, ç'faj kam që nuk dini të më shfrytëzoni në mënyrë të drejtë dhe me një orar më të shkurtër, më së shumti një orë në ditë. E kur të rriteni do ta kuptoni vlerën time dhe do të më shfrytëzoni sa herë që keni nevojë.

Alba - Vëllaçko im i dashur, e sheh që unë veproj në mënyrë të drejtë dhe njerëzit si unë janë arsyeja që ti sot luan me kompjuter.

Pas leximit, nxënësit tregojnë çfarë mendojnë për radion, kompjuterin, librin dhe televizorin. Mendimet e tyre shënohen në tabelë.

Radioja	Libri	Kompjuteri	Televizori

Hapi 3: A ju pëlqeu tregimi dhe çfarë mësuat nga ai? Nxënësit, të pavarur, i plotësojnë rubrikat.

Çfarë lexova?	Çfarë mësova?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për vlerësimin e personazheve dhe shprehjen e mendimeve praktike, angazhimin dhe bashkëpunimin.

Detyrë:

Mëson pjesën e tekstit të caktuar për lojën teknike.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Luan rolin e moderatorit gjatë aktiviteteve brenda klasës.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.1, 1.4, I.6, VI.2, VI.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Lojë skenike - Rinori dhe Alba (përsëritje)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson lojën e shokëve a shoqeve;
- Shpreh mendimet personale rreth porosisë së tekstit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Përmes videoprojektorit, shfaqet para nxënësve loja skenike “Shtëpia prej bore”, në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=LAYDN7CwrUk>. Pasi ta kenë shikuar, parashtrohen pyetje të tilla si:

- A keni qenë ju ndonjëherë në teatër?
- Ju pëlqen loja në role që bëjnë aktorët?
- Cila është shfaqja më e bukur që keni shikuar?
- A dëshironi që edhe ju të bëheni aktorë?

Hapi 2: Nxënësit tashmë kanë mësuar pjesët e caktuara nga ora e kaluar. Nga letra dhe kartoni janë përgatitur veshjet për secilin personazh.

Ndërkohë që moderatori/moderatorja lexon pjesën hyrëse të lojës skenike, aktorët futen në skenë. Secili përpiqet të luajë sa më bukur dhe bindshëm pjesën e vet.

Mediet

LOJË SKENIKE - MEDIET

Rinori dhe Alba

Alba, pasi kreu mësimet dhe detyrat, po luante një lojë në kompjuter. Ajo po kënaqej, por lojës ia kishte lëshuar zërin shumë dhe po e pengonte vëllanë që ishte duke lexuar një lektyrë. Ata filluan të ziheshin me njëri-tjetrin.

Rinori - E sheh që më pengon me tërë atë zë?

Alba - Po vëlla, ti vetëm lexon liber e nuk je duke mësuar, çfarë të keqe ka që luaj? Unë i kreqva mësimet e tani jam duke u relaksuar.

Rinori - Si ç'të keqe ka? Ti luan tashmë që 1 orë dhe rrezatohesh me rreze të dëmshme për shëndetin tënd.

(Duke dëgjuar këtë bisedë, libri, radioja, televizori dhe kompjuteri vendosin të përfshihen.)

Kompjuteri - Rinor, ore Rinor, ç'të keqe kanë lojërat e mia?

Radioja - Si ç'të keqe? Ua shkatërrove sytë fëmijëve. Më mirë të dëgjojnë muzikë dhe të kënaqen me mua.

Televizori - Muzikë?! Pse të mos argëtohen me filmat e animuar që ua dhuroj?

Libri - Ha-ha-ha! Pse po grindeni kot? Po mos të isha unë me informacione dhe mësim, ju nuk do të zbuloheshit fare. Andaj, fëmijë, lexoni sa më shumë libra, se truri juaj i njomë ka fuqi që të zbulojë gjëra edhe më të mrekullueshme se kompjuteri.

Kompjuteri - Oh, i mjeri unë i mjeri, ç'faj kam që nuk dini të më shfrytëzoni në mënyrë të drejtë dhe me një orar më të shkurtër, më së shumti një orë në ditë. E kur të rriteni do ta kuptoni vlerën time dhe do të më shfrytëzoni sa herë që keni nevojë.

Alba - Vëllaçko im i dashur, e sheh që unë veproj në mënyrë të drejtë dhe njerëzit si unë janë arsyeja që ti sot luan me kompjuter.

Loja e tyre mbështetet me duartrokitje nga nxënësit e tjerë.

Edhe grupet e tjera prezantojnë para klasës.

Hapi 3: Pas përfundimit të prezantimeve nga secili grup, nxënësit e pavarur shkruajnë përshtypjet e tyre lidhur me udhëheqjen e lojës skenike nga moderatori a moderatorja, lojën e personazheve dhe ndjesinë e të qenit aktor.

A ishte e vështirë të luaje në skenë?	Radioja	Libri	Kompjuteri	Televizioni	Moderatori Moderatorja

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për lojën, shprehjen e mendimeve, angazhimin dhe bashkëpunimin.

Detyrë:

Shikon një lojë skenike në internet, kërkon ndihmën e prindërve për përzgjedhjen.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe të skicuara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, 1.2, 1.6, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fletushka e klasës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë;
- Argumenton hartimin e tekstit sipas figurave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, fletë formati A4, ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Parashtrohen pyetjet për diskutim:

- A keni shkruar ndonjëherë duke u bazuar te fotografia ose ilustrimi?
- Cilat gjëra i keni pasur parasysh?

U rikujtohet që kur shkruhet në bazë të fotografive, duhet fillimisht të analizohet me kujdes fotografia. Duhet ndjekur radha e veprimeve sipas fotografive, të përdoret imagjinata, por pa u larguar nga porositja që përcjell fotografia.


Hapi 2: Nxënësit ndahen në grupe dhe kërkohet të krijojnë një histori bazuar në figurat e dhëna.

Mediet

FLETUSHKA E KLASËS

Shkruaj një histori bazuar në figurën e dhënë:

Grupi A



Shkruaj një histori bazuar në figurën e dhënë dhe plotëso me fjalët që mendon se i kanë përdorur bashkeflesit.

Grupi B



55

Mediet

Shkruaj një histori bazuar në figurën e dhënë dhe plotëso me fjalët që mendon se i kanë përdorur bashkëfolësit.

Grupi C




Shkruaj një histori bazuar në figurën e dhënë dhe plotëso me fjalët që mendon se i kanë përdorur bashkëfolësit.

Grupi Ç



56



Hapi 3: Përfaqësuesi i secilit grup lexon historinë e shkruar. Nxiten nxënësit e grupeve të tjera të komentojnë, të bëjnë pyetje dhe të japin sugjerime. Edhe përfaqësuesit e grupeve të tjera vazhdojnë me prezantimin e shkrimeve të tyre. Shpjegohet që një punë cilësore kryhet me përkushtim dhe duhet të ketë kohë të mjaftueshme për realizimin e saj. Prandaj finalizimi i fletushkës do të bëhet në orën tjetër.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet krijimtaria në punime, argumentimi i tekstit, angazhimi në punën grupore, shkrimi i tregimeve bazuar në ilustrime dhe vizatime.

Detyrë:

Shkruan tregimin me kompjuter, kërkon ndihmën e prindërve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe puna

Lënda: Shkathtësi për jetë

Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II

Tema: Mediet

Rezultatet e të nxënit të temës:

Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe të skicuara.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: I.1, 1.2, 1.6, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulēs: 4.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:

Fletushka e klasës - Punë në grupe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton tekstin në bazë të përmbajtjes dhe të ilustrimeve;
- Krijon fletushkën e klasës me punime të shkruara me dorë dhe të skicuara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Videoprojektor, fotografi, ilustrime, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Hapet diskutimi rreth historive të shkruara në orën e kaluar. Nxënësit tregojnë për vështirësitë gjatë realizimit të shkrimeve. Nxiten që përpara se të përshkruajnë tregimet në fletët e përgatituara, të kontrollojnë edhe një herë.

Hapi 2: Pasi t'i kenë shkruar në fletë tregimet, kërkohet që secili grup të emërtojë tregimin e vet. Nxënësit lihen të lirë të vendosin për titullin e tregimit të tyre.

Supozojmë se nxënësit i kanë titulluar në këtë mënyrë tregimet.

Mediet

PUNA NË GRUPE

Grupet A, B, C, Ç, D, Dh - çfarë titujsh do t'u vini tregimeve tuaja?

This image shows a blank sheet of white paper with horizontal blue ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There are approximately 20 lines visible. On the left side, there is a vertical margin line, creating a narrow left margin. The paper appears to be from a notebook or a standard ruled sheet.

Si do ta emërtojë revistën?

Grupi A _____

Grupi B _____

Grupi C

Grupi C _____

Grupi D _____

Grupi Dh_____

58



Grupi A: “Të ndryshëm, por të barabartë”

Grupi B: “Në park”

Grupi C: “Loja në pishinë”

Grupi D: “Loja në rërë”

Grupi E: “Magjistari”

Grupi F: “Qeni im Pupi”

Hapi 3: Pasi të jenë emërtuar tekstet, lipset që ato të paraqiten edhe si ilustrime.

Në fund kërkohet që secili grup të propozojë emërtimin e revistës. Nxënësit zgjedhin emrin me të cilin do ta emërtojnë atë. I ndihmojmë ata t’i lidhin dhe t’i bashkojnë tregimet me ilustrimet përkatëse.

Kjo do të jetë fletushka e parë që do të ruhet në arkivin e klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi bëhet për emërtimin e tekstit, krijimtarive, angazhimin mbi emërtimin e tregimeve dhe të fletushkës së klasës.

Detyrë:

Provon të krijojë një fletushkë me vjersha, tregime dhe vizatime.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

